




safejournalists.net

KOSOVË

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2020



KOSOVË
Treguesit e nivelit
të lirisë së mediave
dhe sigurisë së
gazetarëve
2020

Autore
Getoarbë Mulliqi Bojaj

Titulli origjinal

KOSOVË Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve 2020

Botuesi

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Autore

Getoarë Mulliqi Bojaj

Recensent

Dren Gërguri

Lektura në gjuhën shqipe

Anyla Zajmi

Tirazhi

50 kopje

Dizajni

comma | communications design

Ky botim është prodhuar me mbështetje financiare të Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Shoqatës së Gazetarëve të Kosovës dhe në të nuk pasqyrohen domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.



PASQYRA DHE FUSHËVEPRIMI I PROJEKTIT	4	B Pozita e gazetarëve në redaksi	17
NJË SHËNIM MBI METODOLOGJINË	5	B1 Kufizimet ekonomike ndaj lirisë së gazetarëve	16
Hyrje	7	B2 Pavarësia editoriale në mediat private	18
A Mbrojtja Ligjore	9	B3 Pavarësia editoriale në Transmetuesin Publik	19
A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe aplikimi i tyre në praktikë	9	B4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jo-fitimprurëse	19
A2 Efektet e ligjeve kundër shpifjes të gazetarëve	11	B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	20
A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	13	B6 Pozita ekonomike e gazetarëve	21
A4 Liria e punës dhe asociacionit të gazetarëve garancitë ligjore dhe praktika	14	C Siguria e gazetarëve	22
A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	15	C1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkimeve	22
A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata	15	C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe aktorëve politikë lidhur me mbrojtjen e gazetarëve	25
		C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve	26
		Përfundime dhe rekomandime	29

PASQYRA DHE FUSHËVEPRIMI I PROJEKTIT

Është viti i pestë me radhë që asociacionet e gazetarëve nga shtetet e Ballkanit Perëndimor (Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Kosova dhe Serbia), me mbështetjen e Komisionit Europian,¹ monitoruan zhvillimin e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në vendet e tyre. Në vitin 2020, edhe dy shtete të tjera do të punojnë në vlerësime të tilla – Shqipëria dhe Kroacia. Metodologjia e hulumtimit e zhvilluar në vitin 2016² është përshtatur me kalimin e viteve për ta standardizuar mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe për ta përshtatur përqendrimin e hulumtimit me zhvillimet si në mjedisin tradicional ashtu edhe në atë online të mediave në vendet e Ballkanit Perëndimor. Bazuar në këto mjete të standardizuara të hulumtimit, asociacionet e gazetarëve i vlerësuan zhvillimet më të fundit në vendet e tyre dhe u angazhuan në aktivitete të ndryshme avokimi për ta përmirësuar mjedisin politik, legjislativ dhe institucional në të cilin punojnë gazetarët dhe mediat.

-
- ¹ Në dhjetor të vitit 2019, Komisioni Evropian miratoi projektin trevjeçar [Safejournalists.net](https://www.safejournalists.net), me qëllim të fuqizimit të asociacioneve kombëtare të gazetarëve në shtetet e Ballkanit Perëndimor për t'u bërë akterë të pavarur efektiv dhe llogaridhënës në avokimin e aplikimit të standardeve të BE-së në fushën e lirisë së mediave, me një synim afatgjatë të avancimit të së drejtës së qytetarëve për zgjedhje të informuar. Ky Veprim paraqet një zgjerim të projektit të kaluar (Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Avokimin për Lirinë e Mediave dhe Sigurinë e Gazetarëve), bazuar në njohuritë dhe përvojën e fituar në periudhën 2016-2018. Veprimi përkrahet nga Programi i Mediave dhe Shoqërisë Civile 2018-2019, Mbështetja për rrjetet tematike rajonale të organizatave të shoqërisë civile, mbështetja për rrjetet rajonale për të drejtat e grave dhe barazi gjinore dhe mbështetja për projektet e vogla që promovojnë bashkëpunimin mes komuniteteve dhe qytetarëve nga Serbia dhe Kosova.
 - ² Botimi i pestë i përshtatur i metodologjisë së hulumtimit për këtë projekt hulumtimi për avokimin u zhvillua nga Snezana Trpevska dhe nga Igor Micevski, kolegë hulumtues të Institutit të Hulumtimeve mbi Zhvillimet Sociale RESIS nga Maqedonia e Veriut (www.resis.mk).

NJË SHËNIM MBI METODOLOGJINË

Metodologjia e hulumtimit përbëhet nga tre grupe treguesish të zhvilluar në bazë të një analize sistematike të udhëzimeve të ndryshme të hartuara nga organizatat relevante ndërkombëtare.³ Gjatë viteve të kaluara, treguesit e zhvilluar fillimisht janë testuar dhe janë përmirësuar për ta adresuar kontekstin karakteristik socio-politik në këtë rajon dhe për t'i reflektuar nevojat dhe interesat specifike të gazetarëve në këto shtatë vende.

Një varg metodash të ndryshme hulumtuese janë aplikuar për të mbledhur dhe analizuar të dhëna për t'iu përgjigjur pyetjeve indikative në lidhje me secilin tregues të veçantë:

- Shqyrtimi i studimeve, analizave, raporteve të hulumtimeve, politikave, strategjive dhe dokumenteve të tjera;
- Analiza cilësore e dokumenteve ligjore;
- Nxjerrja dhe analizimi i informatave të publikuara në uebfaqet e institucioneve publike dhe organizatave e organeve të tjera;
- Nxjerrja dhe analizimi i komunikatave për shtyp, njoftimeve dhe informatave të tjera të prodhuara nga organizatat profesionale;
- Të dhëna dytësore të mbledhura nga asociacionet e gazetarëve;
- Intervista të detajizuara me ekspertë, gazetarë, politikëbërës, etj.;
- Grupe fokusi me gazetarë, dhe
- Anketa me gazetarë (në disa prej vendeve).

Në nivel kombëtar, asociacionet e gazetarëve nominuan hulumtues kombëtarë për ta bërë mbledhjen e të dhënave dhe për të hartuar raporte narrative, të cilat pastaj u rishikuan nga ekspertë kombëtarë të nominuar dhe nga hulumtues kryesorë. Në Kosovë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës nominoi Getoarbë Mulliqi Bojaj si hulumtues kombëtarë dhe Dren Gërgurin si ekspert i mediave për rishikimin e raportit.

Tre grupet e treguesve që janë përdorur në vlerësimin e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor janë paraqitur në Tabelën në vijim.

Tabela 1: Treguesit e lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

A. Mbrojtja ligjore	B. Pozita e gazetarëve në redaksi	C. Siguria e gazetarëve
A.1 Garancitë ligjore për lirinë e medias dhe gazetarëve dhe zbatimi i tyre në praktikë	B.1 Kufizimet ekonomike në lirinë e gazetarëve	C.1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkimit
A.2 Efektet e ligjit kundër shpifjes tek gazetarët	B.2 Pavarësia editoriale në mediat private	C.2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe akterëve politikë në lidhje me mbrojtjen e gazetarëve
A.3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media	B.3 Pavarësia editoriale në transmetuesin e shërbimit publik	C.3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve
A.4 Liria e punës dhe asociacionit të gazetarëve	B.4 Pavarësia editoriale në mediat jo-fitimprurëse	
A.5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve	B.5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve	
A.6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata	B.6 Pozita ekonomike e gazetarëve	

³ Dokumentet vijuese janë marrë parasysht gjatë zhvillimit të qasjes specifike hulumtuese për shtetet e Ballkanit Perëndimor: Këshilli i Evropës: Treguesit për Media në Demokraci; UNESCO: Treguesit e Zhvillimit të Mediave (TZHM) dhe Treguesit e Sigurisë së Gazetarëve: Niveli kombëtar; USAID – IREX: Indeksi i Qëndrueshmërisë së Mediave; Freedom House: Anketë për Lirinë e Shtypit; BBC World Service Trust: Nisma Afrikane për Zhvillimin e Mediave; Komisioni për Mbrojtjen e Gazetarëve: Dhuna ndaj gazetarëve; Raportuesit pa Kufi: Indeksi Botëror i Lirisë së Shtypit.

Kosova është themeluar si republikë unitare parlamentare me një qeveri, legjislaturë unikamerale dhe një sistem të së drejtës civile. Kosova funksionon dhe trajtohet si shtet i pavarur nga një numër i madh shtetesh, edhe pse shtetësia e saj kontestohet nga një pakicë e shteteve anëtare të OKB-së. Kosova është kandidatë e mundshme për anëtarësim në BE dhe e ka nënshkruar një Marrëveshje të Stabilizim Asocimit me BE-në në tetor 2015 që është në fuqi që nga prilli 2016. Kosova ka një demografi të larmishme, ku shqiptarët e Kosovës përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë dhe serbët, boshnjakët, turqit, romët e goranët dhe të tjerët përbëjnë pjesën tjetër të popullsisë.

Konteksti politik në Kosovë ishte sfidues gjatë vitit 2020 pasi që qeveritë u ndërruan për shkak se Kuvendi i Kosovës votoi për mocionin e mosbesimit kundër Qeverisë së Albin Kurtit.⁴ Votimi i mocionit të mosbesimit çoi në krizë politike, veçanërisht për shkak të procedurave kushtetuese lidhur me formimin e qeverisë së re. Pasi që Gjykata Kushtetuese e sqaroi çështjen, një qeveri e re e udhëhequr nga Kryeministri Avdullah Hoti filloi punën më 3 qershor 2020.⁵

Kriza ekonomike në Kosovë e shkaktuar nga pandemia COVID-19 kishte një ndikim zinxhiror në sektorin e mediave. Për shkak të pandemisë, tregu i punës u sfidua edhe më shumë dhe çoi në zhvillim më të dobët ekonomik të Kosovës, pasi që

4 *European Western Balkans*, "Kuvendi i Kosovës votoi një mocion mosbesimi për Qeverinë Kurti", Prishtinë: 2020, qasur më 20.05.2020, <https://europeanwesternbalkans.com/2020/03/26/assembly-of-kosovo-passes-a-motion-of-no-confidence-in-kurtis-government/>

5 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2020", Bruksel: 2020, qasur më 25.11.2020, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

tashmë ekzistonte një zgjerim i ngadalshëm ekonomik dhe rritje e dobët në eksport e përqendruar kryesisht në eksportimin e shërbimeve. Në mesin e rasteve më shqetësuese të cenimit të të drejtave të punës dhe me pasoja ekonomike në sektorin e mediave gjatë pandemisë COVID-19 ishte largimi nga puna i më shumë se 20 punonjësve të medias të kompanisë Zëri.

Që nga 13 marsi 2020, kur u raportua rasti i parë me COVID-19 në vend, gazetarët, kameramanët dhe fotoreporterët, me lejen e autoriteteve qeveritare, vazhduan të punojnë në kushte të izolimit të përgjithshëm, përkundër rrezikut të infektimit me virusin korona. Kostoja e përgatitjes teknike, printimit dhe shpërndarjes, kufizimi i plotë i lëvizjes së qytetarëve dhe mbyllja e pikave të shitjes në muajt e parë të pandemisë bënë që publikuesit e gazetave ta ndërprejnë vendosjen e gazetave ditore në treg, siç ishin: Bota Sot, Epoka e Re, Koha Ditore dhe Zëri.⁶

Bazuar në mbulim, shtrirja mediatike e Kosovës përbëhet nga dy nivele: mediat kombëtare dhe mediat rajonale. Sipas Raportit Vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) për vitin 2019,⁷ Kosova ka 19 stacione funksionale televizive, 86 radio stacione, 41 operatorë distribuimi dhe 97 ofrues të shërbimeve audio-vizuale mediatike. Në mesin e tyre, janë 13 transmetues televiziv në gjuhën shqipe, duke përfshirë transmetuesin publik, pesë transmetues televiziv në gjuhën serbe dhe një që transmeton në gjuhën turke. Prej 86 radio stacioneve të licencuara, 53 transmetojnë në gjuhën shqipe, duke përfshirë dy radio stacionet publike, 22 në gjuhën serbe, tre në gjuhën boshnjake, dy në gjuhën turke, dy në gjuhën gorane, një në gjuhën rome dhe një radio stacion multietnik.

Megjithatë, në vitet e fundit, shtrirja mediatike e Kosovës është pasuruar me media të reja dhe ndryshime në pronësi si dhe ekipe editoriale. Gazeta Express, portali online me numrin më të madh të lexuesve/shikimeve, zgjeroi organizatën e saj për ta përfshirë kanalin televiziv (T7), Rrokum TV iu shit Arben Ahmetit nga ish-prognari Migjen Kelmendi, i cili pastaj e themeloi Kanalin 10.⁸

6 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve", Prishtinë: 2020, qasur më 25.11.2020, <http://oag-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/THE-IMPACT-OF-COVID-19-PANDEMIC-ON-THE-ECONOMIC-SITUATION-OF-JOURNALISTS-CAMERAMEN-AND-PHOTOJOURNALISTS.pdf>

7 IMC, "Raportit vjetor i punës për vitin 2019", Prishtinë: 2020, qasur më 25.11.2020, <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Publikime/Raportit%20Vjetor%202019%20KPM.pdf>

8 SEENPM, Instituti i Paqes, Kosovo 2.0, "Shtrirja e mediave në Kosovë: Ndikimet e urrejtjes dhe propagandës", Ljubljana: 2020, qasur më 19.04.2020, <https://seenpm.org/wp-content/uploads/2020/10/Resilience-research-publication-1-KOS-ENG.pdf>

A1 Garancitë ligjore për lirinë e mediave dhe aplikimi i tyre në praktikë

A është e garantuar e drejta për lirinë e shprehjes dhe informimit? A e përfshin gjithashtu qasjen në internet? A zbatohen në praktikë garancitë ligjore?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e shprehjes, lirinë e informimit, lirinë e së drejtës së mediave për qasje në dokumente publike si dhe të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre për t'i krijuar dhe përdorur mediat e tyre.⁹ Edhe pse nuk thuhet në mënyrë të drejtpërdrejtë, këto garanci përfshijnë edhe të drejtën për qasje në internet. Kushtetuta po ashtu përcakton që e drejta për liri të shprehjes mund të kufizohet vetëm me ligj, në rast se është e nevojshme për ta parandaluar nxitjen apo provokimin e dhunës në bazë të urrejtjes racore, kombëtare, etnike apo fetare.¹⁰ Liria e shprehjes është e garantuar edhe me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes,¹¹ i cili parashihet një ekuilibër në mes të rolit esencial të medias si roje publike dhe të drejtës individuale për reputacion dhe dinjitet. Edhe ligjet e tjera përmbajnë dispozita të

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qasur më 25.11.2020, <https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislatiori/1362558264.286.pdf>

¹⁰ *Ibid*, Neni 40.

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 02/L-65 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, qasur më: 25.11.2020, http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=129&Itemid=28

hollësisht për zbatimin e garancive kushtetuese dhe rastet në të cilat ato mund të kufizohen, siç është Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave,¹² Ligji për Qasje në dokumente publike,¹³ Ligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve,¹⁴ Kodi Penal (ndalimi i nxitjes së urrejtjes).¹⁵ Megjithatë, edhe pse garancitë janë të formuluar mirë në ligje, në disa fusha zbatimi i tyre është shumë i dobët.¹⁶ Në raportin e progresit për vitin 2020, Komisioni Evropian theksoi që edhe pse Kosova ka arritur një nivel të përmirësimit sa i përket lirisë së shprehjes, e cila është e mishëruar në Kushtetutë, ende ekzistojnë disa çështje shqetësuese siç janë kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve, cenueshmëria e transmetuesit publik ndaj ndikimeve politike dhe pasiguria e tij financiare.¹⁷

A është hartuar legjislacioni për media përmes një procesi transparent dhe gjithëpërfshirës në konsultim me asociacionet përkatëse profesionale?

Legjislacioni për media i zbatueshëm në Kosovë është zhvilluar në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me partnerët e brendshëm e të jashtëm, duke përfshirë asociacionet e gazetarëve profesionistë dhe OJQ-të mediale. Duke e thënë këtë, duhet të ceket që nga janari deri në dhjetor 2020, kishte një nismë nga Komisioni i Pavarur i Mediave për ta ndryshuar Kodin e Etikës, por u pezullua pas shqetësimeve të ngritura nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, OJQ të ndryshme dhe ekspertë e juristë të tjerë të mediave¹⁸ për shkak të mungesës së transparencës.

A kishte përpjekje nga autoritetet shtetërore për ta vendosur si kusht licencimin ose kushte të tjera të rrepta për themelimin e mediave të shkruara dhe të atyre me bazë në internet? A ka kushte të tjera përveç regjistrimi të biznesit dhe taksave?

Autoritetet shtetërore në Kosovë nuk imponojnë kushte paraprake dhe të rrepta për mediat me bazë në internet për regjistrimin e tyre. Këto media operojnë si subjekte afariste të regjistruara në Agjencinë për

Regjistrimin e Bizneseve dhe regjistrohen drejtpërdrejtë në Administratën Tatimore të Kosovës.¹⁹ Performanca e tyre monitorohet nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës por vetëm sa i përket respektimit të parimeve etike të raportimit.²⁰

A ka pasur përpjekje nga autoritetet shtetërore për ta kufizuar të drejtën e qasjes në Internet ose për të kërkuar bllokimin ose filtrimin e përmbajtjes së internetit?

Ligji për Komunikimet elektronike i rregullon aktivitetet e komunikimit elektronik bazuar në parimin e neutralitetit teknologjik dhe siguron të drejtën për qasje në shërbime të duhura të komunikimit.²¹ Nuk ka asnjë përpjekje të njohur apo të raportuar nga autoritetet shtetërore për ta kufizuar të drejtën e qasjes në internet apo për ta bllokuar apo filtruar përmbajtjen e publikuar në internet.

A po i kryen autoriteti rregullativ funksionet e veta në mënyrë të pavarur dhe jo-diskriminuese? A kryhen licencimet dhe rregulloret e tjera të transmetimit në mënyrë të drejtë dhe neutrale?

Komisioni i Pavarur i Mediave në Kosovë është i themeluar në mënyrë ligjore për të vepruar si autoritet i pavarur rregullativ. Megjithatë, konsiderohet se veprimtaria e tij ende ndikohet nga partitë politike, për faktin se përzgjedhja e organit vendimmarrës bëhet nga partitë politike në parlament, e jo me procedura që garantojnë pavarësi.²²

A abuzohet me dispozitat ligjore për marketingun shtetëror në media për ndikim politik mbi politikën e tyre editoriale? A është alokimi i fondeve shtetërore transparent, i drejtë dhe jo-diskriminues? A i publikojnë institucionet shtetërore rregullisht të dhënat për shumën e alokuara për media të ndryshme?

Bazuar në gjetjet tona, problem kryesor është mostransparenca e institucioneve në lidhje me shpenzimet që i bëjnë në mediat lokale dhe nacionale. Megjithatë, duke pasur parasysh që në vitin 2020 institucionet nuk ofruan asnjë raport mbi shpenzimet financiare për informim publik, bazuar në raportin e vitit 2019, që përmban përg-

12 Ligji Nr. 04/L-044.

13 Ligji Nr. 03/L-215.

14 Ligji Nr. 04/L-137.

15 Kodi Penal, Neni 147.

16 Flutura Kusari, eksperte në ligjin për media, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.10.2020.

17 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2020", Bruksel: 2020, qasur më 25.11.2020, https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosova_report_2020.pdf

18 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, "Pas ankesave nga AGK dhe shoqëria civile, KPM pezullon procesin e ndryshimit të Kodit të Etikës", Prishtinë:2020, qasur më 25.11.2020, <http://agk-ks.org/en/following-complaints-from-ajk-and-civil-society-ipc-suspends-the-process-of-amending-the-code-of-ethics/>

19 Ibid.

20 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, <https://presscouncil-ks.org/about-us/?lang=en>

21 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, <https://azk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2851>

22 Flutura Kusari, eksperte në ligjin për media, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.10.2020.

jigjet e dërguara nga 35 institucione të nivelit lokal dhe qendror, shpenzimet e përgjithshme të mediave ishin 598,917.71 euro.²³

Paratë e shtetit zakonisht ndahen për shpalljen e vendeve të lira të punës, njoftime për tenderë, apo fushata ndërgjegjësuese në media për migrimin, vaksinimin, etj. Përderisa nuk ka asnjë lidhje të drejtpërdrejtë të krijuar në mënyrë të qartë mes shpenzimeve të qeverisë në media dhe ndikimit të saj në politikën editoriale, së fundmi ka pasur disa diskutime në media për rreziqet nga ndikimi në rritje të qeverisë.

A ka ndonjë lloj subvencionimi për media ose fonde për prodhimin e përmbajtjes mediatike me interes publik dhe si zbatohen ato në praktikë?

Në Kosovë nuk ka subvencione për Media për t'i përkrahur mediat publike ose private që nga viti 2011, duke i lënë Organizatat Ndërkombëtare të ofrojnë skema të ndryshme të financimit.

Cilët janë mekanizmat për financimin e mediave në gjuhët e pakicave etnike?

Nuk ka mekanizma të veçantë për financim ose mbështetje financiare të mediave private ose jofitimprurëse që publikojnë përmbajtje në gjuhët e pakicave të ndryshme etnike. Të gjitha mediat e tjera private, duke përfshirë ato të pakicave kombëtare, që janë të regjistruara si biznese, duhet t'i sigurojnë vetë të ardhurat e tyre.

Transmetuesi publik (RTK) është i detyruar ligjërisht të ndajë 10% të buxhetit të tij të përgjithshëm të marrë nga të gjitha burimet për kanalin në gjuhën serbe. RTK do të vazhdojë të ndajë 10% të buxhetit të tij të përgjithshëm për kanalin e dytë të RTK-së në gjuhën serbe pas ndërprerjes së financimit nga Buxheti i Kosovës dhe Themeluesi.²⁴

23 Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, "Raport mbi shpenzimet financiare të institucioneve për informim publik", Prishtinë: 2019, qasur më 20.10.2020, <http://gqk-ks.org/wp-content/uploads/2019/05/Asociacioni-i-Gazetar%C3%ABve-f%C3%AB-Kosov%C3%ABs-1.pdf>

24 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji për Radio Televizionin e Kosovës", qasur më 20.12.2020, https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2812&fbclid=IwAR2Dps_7YS6edpsswOYD1ksIEFmkT7qkfEbcVJbgfOROIYpD7Mj5Rh00YZJA

A garantohet dhe mbrohet në mënyrë efikase autonomia dhe pavarësia e TSHP-së? A e garanton korniza e financimit pavarësinë dhe stabilitetin e tij? A është organi mbikëqyrës përfaqësues i shoqërisë në përgjithësi?

Edhe pse autonomia dhe pavarësia e TSHP-së është e garantuar me ligj (Nr. 04/L-046)²⁵ transmetuesi publik ballafaqohet me presion dhe ndikim politik për shkak se është i financuar nga shteti.²⁶ RTK ende financohet drejtpërdrejtë nga shteti dhe buxheti i tij caktohet çdo vit nga Kuvendi²⁷ gjë që e dobëson pavarësinë e tij editoriale dhe e lë të cenueshëm ndaj ndikimeve politike.²⁸ Prandaj, Komisioni Evropian theksoi që Ligji për RTK-në duhet të ndryshohet në përputhje me praktikën më të mira për financim të qëndrueshëm dhe për të siguruar përzgjedhje transparente dhe profesionale të anëtarëve të bordit të tij.²⁹ Organi mbikëqyrës ose Bordi i RTK-së është i themeluar në mënyrë ligjore për ta reflektuar karakterin multi-etnik dhe gjinor të Kosovës.³⁰

A2 Efektet e ligjeve kundër shpifjes te gazetarët

A janë dispozitat e ligjeve kundër shpifjes të repta dhe a i mbrojnë ato zyrtarët e shtetit? Cilat janë mangësitë kryesore të këtyre ligjeve?

Ligji Nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes³¹ nuk i mbron jashtë mase zyrtarët publikë, por ua jep

25 [Ibid.](#)

26 Komisioni Evropian, "Raporti i vitit 2019 për Kosovën", Bruksel: 2019, qasur më 20.12.2020, <http://mei-ks.net/repository/docs/kosovo-report.pdf>

27 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2020", Bruksel: 2020, qasur më 25.11.2020, https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/kosovo-report_2020.pdf

28 KlanKosova TV, "Hoti: RTK-ja më nuk do të financohet nga Buxheti i Kosovës", qasur më 12.12.2020, <https://klankosova.tv/hoti-rtk-ja-me-nuk-do-te-financohet-nga-buxheti-i-kosoves/>

29 Komisioni Evropian, "Dokument Pune i Stafit të Komisionit Raporti për Kosovën për vitin 2020", Bruksel: 2020, qasur më 25.11.2020, https://ec.europa.eu/neighborhood-enlargement/sites/near/files/kosovo-report_2020.pdf

30 Neni 25 i Ligjit 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës përcakton që së paku dy (2) anëtarë të Bordit të RTK-së duhet të emërohet nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar duhet të emërohet nga komunitetet tjera jo-shumicë dhe së paku dy (2) anëtarë të gjinisë femërore. Së paku dy (2) anëtarë të Bordit duhet t'i plotësojnë kualifikimet profesionale në financim, menaxhim biznesi dhe çështje ligjore, qasur më 20.12.2020, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2812>

31 Gazeta Zyrtare, "Ligji Nr.02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes", qasur më 05.01.2021, http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=129&Itemid=28&lang=en

gazetarëve një shkallë më të lartë të tolerancës duke i mbajtur ata përgjegjës vetëm nëse e kanë ditur paraprakisht që informatat kanë qenë të rreme. Ai ua ndalon autoriteteve publike të paraqesin kërkesë për kompensim të dëmit për shpifje apo fyerje, por zyrtarët publikë mund ta bëjnë këtë vetëm në kapacitetin e tyre personal.³² Po ashtu, Gjykata Kushtetuese ka konfirmuar që deputetët e Kuvendit të Kosovës gëzojnë vetëm imunitet funksional, pra nëse përfshihen në ndonjë akt penal, mund të paditen, [d.m.th.](#), mund t'i nënshtrohen vështrimit hulumentues dhe kritikave të publikut.

Sa procese gjyqësore janë iniciuar kundër gazetarëve nga zyrtarë shtetërorë dhe politikanë gjatë vitit të kaluar?

Për shkak të faktit se nuk ka bazë të të dhënave për rastet që i përfshijnë gazetarët në mënyrë specifike në gjykata, nuk dihet numri i padive të ngritura kundër gazetarëve nga zyrtarët shtetërorë dhe/ose politikanët. Mbledhja e të dhënave nga institucionet gjyqësore do të finalizohet në fund të gjysmës së parë të vitit 2021.³³ Kjo mbledhje e të dhënave do të ndihmojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve ligjore.

Deri në çfarë mase janë politikisht të motivuara vendimet e gjykatës kundër disa gazetarëve? Çfarë lloj dënimesh janë shqiptuar?

Edhe pse gjatë periudhës raportuese nuk është raportuar asnjë shembull konkret i dispozitave ligjore që janë përdorur për t'i heshtur gazetarët, është vënë re që gjohet janë lloji më i zakonshëm i ndëshkimeve që jepen nga gjykatësit. I njëjti model është përdorur në rastet kur gazetarët janë viktima të akteve kriminale, gjë që krijon një përshtypje që kjo qasje në mënyrë indirekte nxit sulme ndaj gazetarëve.³⁴

A e njohin gjykatat mekanizmin e themeluar vetë-rregullativ (nëse ka)? A e pranojnë validitetin e një përgjigjeje, korrigjimi ose faljeje të publikuar ose të shpërndarë?

Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes³⁵ i njeh mekanizmat vetërregullativë, duke konsideruar zbatueshmërinë e urdhërave apo udhëzimeve nga Këshilli i Mediave të Shkuara apo ndonjë organ përkatës rregullativ, si një

rrethanë lehtësuese. Më tutje ai e obligon gjykatën që t'i marrë parasysh masat e ndërmarra nga autori, redaktori apo publikuesi ose dikush që ka ushtruar kontroll mbi përmbajtjen e tij në lehtësimin e dëmeve nëse dëshmojnë që kanë kërkuar falje ose kanë ofruar të kërkojnë falje apo korrigjim para fillimit të veprimit për dëme ose sapo të kenë pasur mundësi.³⁶ Mekanizmat vetërregullativ shërbejnë si instrument për ta ngritur nivelin e profesionalizmit dhe për t'i pajtuar palët që janë të pakënaqura me raportimin e mediave dhe mediat që janë objekt i shkeljeve. Këta mekanizma kanë për qëllim të krijojnë disiplinë dhe ta rrisin performancën profesionale të mediave.³⁷

Çfarë mendojnë gazetarët për ligjin kundër shpifjes? A i dekurajon ky ligj ata që të hetojnë dhe të shkruajnë në mënyrë kritike?

Ligji kundër Shpifjes nuk konsiderohet dekurajues nga gazetarët në realizimin e detyrave të tyre pasi që besojnë se kanë mbrojtje të mjaftueshme sa u përket padive kundër shpifjeve.³⁸ Megjithatë, gazetarët e konsiderojnë si barrë shtesë për shkak se ligji ndëshkon edhe informatat e pasakta të paqëllimshme gjë që mund të ndikojë në punën e tyre.³⁹

32 Flutura Kusari, eksperte në ligjin për media, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.10.2020.

33 Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.01.2021.

34 Betim Musliu dhe Ehat Miftaraj, përfaqësues të Institutit Ligjor të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 20.12.2020.

35 Gazeta Zyrtare, Ligji Nr. 02/L-65 Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, qasur më 05.01.2021, http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=com_content&task=view&id=129&Itemid=28&lang=en

36 Në pajtim me Ligjin Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Neni 12), para parashtrimit të një padie sipas këtij Ligji, një person që pretendohet të jetë i dëmtuar do të ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme për të zbutur çdo dëm të shkaktuar nga shpifja. Në veçanti, paditësi do të kërkojë përmirësimin e asaj shprehjeje nga personi i cili pretendohet ta ketë shkaktuar dëmin. Veprimet e tilla mund ta përfshijnë kërkesën e përmirësimit të shprehjes së supozuar shpifëse apo fyese nga publikuesi dhe paraqitjen e kërkesës para organit kompetent rregullativ sikurse (Komisioni i Pavarur për Media) ose Organi vetërregullativ sikurse (Këshilli për Mediat e Shkuara).

37 Betim Musliu & Ehat Miftaraj, përfaqësues të Institutit Ligjor të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 20.12.2020.

38 Tre grupe fokusit me gazetarë nga mediat e shkuara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj dhe Vesa Bala (15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021).

39 Shkumbin Kajtazi, gazetar hulumentues, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 17.01.2021.

A3 Mbrojtja ligjore e pluralizmit politik në media

A është i rregulluar pluralizmi politik në media nga legjislati i mediave jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet e TSHP-së dhe ato të transmetuesve privatë në lidhje me pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore?

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ofron garanci të përgjithshme për pluralizmin në media (Neni 42)⁴⁰ dhe Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave garanton liri dhe pluralizëm të mediave audio-vizuale në Kosovë (Neni 5).⁴¹ Në legjislatin për media (për transmetuesit publik dhe privat) nuk ka dispozita specifike që i obligon ato të reflektojnë pluralizëm politik gjatë periudhës jozgjedhore, përveç Kodit të Mirësjelljes të KPM-së i cili i obligon transmetuesit e licencuar dhe të gjitha mediat e tjera t'i përmbahen raportimit etik dhe të paanshëm.

A është i detyruar autoriteti rregullativ ta monitorojë dhe ta mbrojë pluralizmin politik jashtë proceseve zgjedhore? Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ i monitoron mediat elektronike dhe të shkruara?

Nuk ka obligim specifik për autoritetin rregullativ për ta mbrojtur pluralizmin politik në media gjatë periudhës jozgjedhore.

A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media jashtë proceseve zgjedhore?

Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, legjislatin sekondar ligjërisht i detyrueshëm i lëshuar nga KPM-ja, përcakton dispozitat për mbulim të balancuar dhe të paanshëm të lajmeve, megjithatë, KPM e monitoron vetëm përmbajtjen gjatë fushatave zgjedhore, prandaj është e vështirë të vlerësohet nëse mediat në Kosovë reflektojnë pikëpamje të ndryshme politike dhe ide jashtë fushatave elektorale.

Cilat janë detyrimet ligjore të mediave gjatë fushatave zgjedhore? Cili organ i monitoron mediat elektronike dhe të shkruara?

Obligimi i të gjitha mediave sipas Ligjit Nr. 003/ L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme është të sigurojnë qasje të barabartë dhe t'i përmbahen Kodit të Mediave të Shkruara të Kosovës,⁴² një Kod i Mirësjelljes (KM) i zhvilluar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), që i përcakton të njëjtat standarde etike për të gjitha mediat edhe gjatë periudhës jozgjedhore. Megjithatë, shpesh është raportuar për mospërputhje në mbulim si nga mediat e shkruara ashtu edhe nga ato transmetuese.

Korniza ligjore në Kosovë kërkon që mediat audio-vizuale të ofrojnë qasje të drejtë dhe të paanshme për të gjitha palët, veçanërisht në mbulimin e fushatave zgjedhore.⁴³ Sipas Ligjit nr. 003/L-073 për Zgjedhjet e përgjithshme (neni 49-53, & 109), KPM-ja ka për obligim ta monitorojë pluralizmin politik përmes qasjes në reklama (falas dhe me pagesë) të ofruara për çdo parti politike nga çdo transmetues, t'i monitorojë shkeljet e mediave, të merret me ankesat dhe të administrojë ndëshkime gjatë periudhës zgjedhore. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) është organi përgjegjës për parashtrimin e kërkesave (duke përfshirë shkeljet e pluralizmit politik) tek KPM-ja.

A kanë partitë politike dhe kandidatët qasje të drejtë dhe të barabartë në media gjatë fushatave zgjedhore?

Gjatë vitit 2020 nuk kishte zgjedhje. Monitorimi i fundit i zgjedhjeve të përgjithshme në vitin 2019 i mbajtur nga KPM-ja u fokusua në të gjitha format e prezantimit të fushatës zgjedhore në media, siç janë: edicionet e lajmeve, spotet politike, kronikat zgjedhore dhe intervistat dhe debatet e transmetuara nga 16:00 deri në 24:00. Para Zgjedhjeve, bazuar në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, KPM nxjerr Udhëzimet për Zgjedhje përmes të cilave i udhëzon të licencuarit si të sillen gjatë periudhës së zgjedhjeve.⁴⁴ Megjithatë, gjatë zgjedhjeve të vitit 2019, u vunë re mospërputhje të vogla në përfaqësimin e partive politike në media, me ç'rast partive

40 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42 [Liria e Mediave] (paragrafi 1), qasur më 03.09.2020, <http://www.kyeministri-ks.net/repository/docs/Constitution%20Kosovo.pdf>

41 Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, Neni 5 Detyrat dhe përgjegjësitë e KPM-së (paragrafi 3), qasur më 04.10.2020, https://www.kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Legjislati/1335250709_2603.pdf

42 Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, qasur më 13.10.2020, <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Udh%C3%ABzues-p%C3%ABr-Kodin-e-Mediave%20t%C3%AB-Shkruara>

43 Ligji Nr. 03-L073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kapitulli VIII Mediat gjatë fushatës zgjedhore, f. 24-27, <https://aceproject.org/ero-en/regions/europe/KS/on-general-elections-in-the-republic-of-kosovo/view>

44 Jean-Francois Furnemont dhe Deirdre Kevin, "Rregullimi i reklamimeve politike: Studim krahasues me reflektime në situatën në Evropën Juglindore", BE dhe Këshilli i Europës, 2020, qasur më 04.02.2021.

të caktuara u është dhënë kohë e caktuar para se zyrtarisht të fillonte fushata zgjedhore.⁴⁵

A4 Liria e punës dhe asociacionit të gazetarëve garancitë ligjore dhe praktika

A duhet që gazetarët të licencohen nga shteti për punën e tyre? A ka pasur ndonjë përpjekje gjatë vitit të kaluar drejt licencimit nga shteti?

Shteti nuk parasheh asnjë formë të licencimit për të punuar si gazetar. Liria e punës dhe lëvizjes nuk janë kufizuar për gazetarët dhe punonjësit e tjerë të mediave, mirëpo ata duhet t'i mbajnë me vete kartelat e identifikimit të lëshuara nga mediat në cilat punojnë në mënyrë që të mund t'i kryejnë detyrat e tyre.

A u është refuzuar gazetarëve e drejta për të raportuar nga ngjarje të caktuara në terren për shkak se nuk kanë qenë të akredituar?

Gjatë vitit 2020, për shkak të pandemisë COVID-19, vendi u izolua prandaj, për t'i kryer punët e tyre, gazetarët duhej të merrnin leje për të vepruar në mënyrë të lirë. Megjithatë, disa gazetarë u penguan gjatë kryerjes së detyrave të tyre.⁴⁶

Për shkak të izolimit të gjerë të Kosovës që u vendos bazuar në masat e miratuara nga Qeveria e Kosovës për parandalimin e COVID-19, policia e pengoi gazetarën Yllka Ahmetxhekaj në kryerjen e detyrës gjatë raportimit nga qendra e karantinës në Prishtinë. Megjithatë, nuk ka raste kur gazetarëve u është refuzuar e drejta për të raportuar nga një ngjarje e caktuar

në terren për shkak të mungesës së akreditimit gjatë vitit 2020.⁴⁷

A janë gazetarët të organizuar në asociacione profesionale dhe nëse po si? A bëhen presione mbi organizatën e tyre ose mbi anëtarët individualë?

Gazetarët kanë të drejtë për një asociacion dhe janë të lirë të formojnë sindikata siç është garantuar me Kushtetutë, me Ligjin nr. 03/L-212 e Punës,⁴⁸ dhe me Ligjin nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë⁴⁹. Aktualisht ekzistojnë dy asociacione të gazetarëve të ndara në baza etnike, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) (420 anëtarë) dhe Asociacioni i Gazetarëve Serbë në Kosovë (120 anëtarë). Gjatë vitit 2020 nuk u raportuan raste të presionit ndaj vetë asociacioneve. Kur AGK reagon në rastet kur shkelen të drejtat e një gazetari/gazetareje që është anëtar/e i/e AGK-së apo të drejtat e një gazetari/gazetareje që nuk është anëtar/e i/e AGK-së dhe kur përfshihet një subjekt politik, presioni bie mbi AGK-në, duke u akuzuar që është partizan i njëjës apo tjetrës parti politike.⁵⁰ Sidoqoftë, AGK reagon në të gjitha rastet dhe vepron si ndërmjetësues mes gazetarit/gazetares dhe institucionit.

A janë gazetarët të organizuar në sindikata dhe, nëse po, si? A ka presione ndaj drejtuesve të sindikatave dhe anëtarëve të tjerë? A u jepet gazetarëve liri që të bëhen anëtarë të sindikatave?

Punonjësit e TSHP RTK janë të vetmit të organizuar në sindikata, aktualisht në tre sindikata (Sindikata e Pavarur e RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të RTK-së, Sindikata e Punëtorëve të Radios). Nuk ekziston asnjë institucion që funksionon në mënyrë të pavarur për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.⁵¹ Pasi që nuk ka sindikata që i përfaqësojnë interesat e të gjithë gazetarëve në Kosovë, AGK në përgjithësi shërben si pika kryesore e kontaktit për gazetarët në rastet e cenimit të të drejtave të tyre, për referimin e tyre të duhur dhe në disa ra-

45 Demokracia në Veprim, "Deklarata preliminare 2019", Prishtina: 2019, f. 8, qasur më 20.10.2020, http://kdi-kosova.org/wp-content/uploads/2019/10/86_FINAL_Deklarata-preliminare-p%C3%ABR-zgjedhjet-e-parakohshme-p%C3%ABR-Kuvendin-e-Kosov%C3%ABs_FINAL_Bleria_ENG.pdf

46 AGK, "AGK e shqetësuar me sjelljen dhe veprimin e policies ndaj gazetares Tatjana Lazarevic", Prishtinë: 2020, qasur më 20.04.2020, <http://aak-ks.org/aak-e-shqetësuar-me-sjelljen-dhe-veprimin-e-policise-ndaj-gazetares-tatjana-lazarevic/?fbclid=IwAR1q0IQBk-qvWqizPa7BcmSmA-fsmaiYksPA7CUDeNQd2pO-ex3nl6seyG0> and "AJK concerned with the behaviour and actions of the police towards the journalist Yllka Ahmetxhekaj", Prishtinë: 2020, qasur më 15.05.2020, http://aak-ks.org/aak-e-shqetësuar-me-veprimin-e-policise-ndaj-gazetares-yllka-ahmetxhekaj/?fbclid=IwAR1cgaldanvRuupbc-6lZsKsM6_fj3WkTq37SZqj4p-INLps3PowTtUuE

47 AGK, "Kërcënime tjera ndaj gazetarëve", Prishtinë: 2020, qasur më 15.05.2020, <http://aak-ks.org/en/rastet/other-threats-to-journalists-yllka-ahmetxhekaj-prishtine-05-05-2020/>

48 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 03/L-212 i punës", qasur më 15.10.2020, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2735>

49 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 04/L-011 për organizimin sindikal në Kosovë", qasur më 15.10.2020, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2754>

50 Gentiana Begolli Pustina, Kryetare e Bordit të AGK-së, e intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 17.11.2020.

51 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, "Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve në Kosovë", Prishtina: 2014, qasur më 15.12.2020, <https://www.osce.org/Kosovo/122390?download=true>

ste ka vepruar edhe si ndërmjetësues mes gazetarëve dhe institucioneve.⁵²

A ekziston Këshili i Mediave të Shkruara dhe si është i organizuar? A ka presione ndaj përfaqësuesve të Këshillit të Mediave?

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) është një organ vetërregullativ që ka filluar punën në vitin 2005 vetëm me gazeta nën juridiksionin e vet. Megjithatë, me ndryshimin e shtrirjes së mediave kah mediat online, KMSHK ka filluar t'i përfshijë edhe ato. KMSHK është i pavarur nga ndikimet politike pasi që Kuvendi nuk ka ndikim në përzgjedhjen e bordit. Nuk ka pasur presione të raportuara ndaj përfaqësuesve të KMSHK-së, megjithatë janë regjistruar raste të presionit nga partitë që janë ankuar, të cilat nuk konsiderohen kërcënime të rënda.⁵³ Aktualisht 50 gazeta dhe media online janë anëtare të KMSHK-së.

A5 Mbrojtja ligjore e burimeve të gazetarëve

Si garantohet me ligj konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve? Në cilat rrethana mund t'i nënshtrohet kufizimeve e drejta për t'i mbrojtur burimet e tyre?

Ligji për Mbrojtjen e burimeve të gazetarëve⁵⁴ vlen në mënyrë specifike për gazetarët dhe garanton konfidencialitet të burimeve të tyre dhe është mbështetur me Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve,⁵⁵ i cili e mbulon çështjen e mbrojtjes së burimit dhe e obligon çdo zyrtar publik t'i mbrojë sinjalizuesit dhe të mos shpërndajë informata tek palët e treta.

A respektohet konfidencialiteti i burimeve të gazetarëve nga autoritetet? A ka pasur shembuj kur gazetarët janë urdhëruar që t'i zbulojnë burimet e tyre dhe a është arsyetuar me mbrojtjen e interesit publik?

Në vitin 2020 nuk kishte raste të gazetarëve që u detyruan t'i zbulonin burimet e tyre; megjithatë, gjykata mban të drejtën për të kërkuar informata të tilla në raste penale kur jeta e një apo më shumë personave është në kërcënim dhe në rast të një kërcënimi ndaj shtetit.

A u vunë sanksione kundër gazetarëve që nuk pranuan ta zbulojnë identitetin e një burimi?

Nuk ka dëshmi të ndëshkimeve të vendosura ndaj gazetarëve gjatë periudhës së raportimit për zbulimin e identitetit të burimit të informacionit.

A ndihen të lirë gazetarët që të kërkojnë qasje dhe të mbajnë kontakte me burimet e informacionit?

Në përgjithësi, gazetarët pohojnë se ndihen të sigurtë për t'i ruajtur lidhjet me burimet e tyre të informacioneve. Megjithatë, disa prej tyre theksojnë që ka raste kur burimet e informacionit nuk ndihen rehat të bashkëpunojnë me gazetarët.⁵⁶

A6 Mbrojtja e së drejtës për qasje në informata

Cilat janë rregullat ligjore për qasje në dokumentet dhe informacionet zyrtare që janë të rëndësishme për gazetarët?

Ligji për Qasje në dokumente publike garanton të drejtat e çdo personi, pa dallim në asnjë bazë, për qasje në dokumentet publike të prodhuara, të marra, të mbajtura apo të kontrolluara nga institucionet publike si dhe të drejtën për ripërdorim të dokumenteve të sektorit publik.⁵⁷

52 IREX, "Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias", f. 9, qasur më 15.12.2020. <https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2019-kosovo.pdf>

53 Imer Mushkolaj, Drejtor Ekzekutiv i KMSHK-së, intervistuar nga Getoarbë Mulliqi Bajaj, 20.11.2020.

54 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarëve", qasur më 15.10.2020, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8864>

55 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve", qasur më 15.10.2020, <https://qzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=1830>

56 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarbë Mulliqi Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

57 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, qasur më 15.10.2020, <https://qzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

A i përdorin gazetaret këto rregulla? A i ndjekin autoritetet këto rregulla pa vonesa? A janë autoritetet shtetërore transparente në përgjithësi? A kanë ato marrëdhënie të hapura, jodiskriminuese dhe të drejta me mediat apo kanë tendencë të punojnë në fshehtësi? A i favorizojnë institucionet shtetërore mediat jokrifikuese ndaj politikës?

Gazetarët janë të kënaqur me ligjin në fjalë por po-
hojnë se institucionet nuk janë plotësisht transparen-
te.⁵⁸ Prandaj, rekomandojnë avancim të mëtejshëm
të mundësisë së publikut për të kërkuar llogari nga
Qeveria.⁵⁹

A janë gjykatat transparente? A sigurohet
qasja e mediave në procedurat ligjore
mbi një bazë jo-diskriminuese dhe
pa kufizime të panevojshme?

Gazetarëve u ofrohet qasje në seanca gjyqësore në
mënyrë jodiskriminuese, pa asnjë kufizim, përveç ras-
teve kur një gjykatës jep urdhër për masa mbrojtëse.
Megjithatë, në vitet 2019-2020 u bë një përpjekje për
ta rishikuar Kodin e Mirësjelljes,⁶⁰ gjë që do ta kufizo-
nte mundësinë e gazetarëve për të raportuar nga se-
ancat gjyqësore, duke i detyruar ata të presin deri në
vendimin e formës së prerë. Pas shqetësimeve të ngrit-
tura nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe or-
ganizatave e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, kjo
përpjekje u pezullua nga KPM-ja.⁶¹ Nuk janë raportuar
raste kur gazetarëve nuk iu është dhënë qasje në rastet
e hapura gjyqësore në vitin 2020.

A sigurohet qasja publike në seancat
parlamentare? A ka kufizime për gazetarët
që e përcjellin punën e Kuvendit?

Gazetarët kanë qasje në Kuvend dhe i mbulojnë seancat
plenare dhe mbledhjet e komisioneve. Po ashtu, në

Kuvend janë më se 400 gazetarë të akredituar.⁶² Brenda
sallës plenare, gazetarët mund t'i mbulojnë seancat, ku
kameranët dhe fotoreporterët mund ta bëjnë këtë nga
galëria (ballkoni).⁶³ Sipas gazetarëve, Parlamenti është
institucioni më transparent në Republikën e Kosovës.⁶⁴
Puna e Kuvendit është e hapur dhe transparente. Të gjit-
tha seancat e Kuvendit, mbledhjet e komisioneve dhe
mbledhjet tjera shpallen paraprakisht në kalendarin e
aktiviteteve, në faqen e Kuvendit në internet. Informatat,
procesverbalet dhe transkriptat nga seancat plenare
të Kuvendit, si dhe të gjitha dokumentet tjera të punës
së përditshme publikohen në uebfaqen e Kuvendit.⁶⁵
Megjithatë, vizitorëve u kërkohet të regjistrohen në
Drejtorinë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun di-
sa ditë para seancës.⁶⁶

Sa të hapur për publikun janë qeveria
dhe ministrinë përkatëse?

Përkundër faktit që të gjitha Ministrinë kanë krijuar ue-
bfaqet e tyre, si dhe kanë hapur kanalet në Facebook,
Instagram, Twitter dhe Youtube, perceptimi i përgjith-
shëm është se qeveria është institucioni më pak trans-
parent, për shkak të faktit se procesi ose tejzgjatet ose
qasja në informacionet e kërkuara nuk jepet fare.

B1 Kufizimet ekonomike ndaj lirisë së gazetarëve

Sa gazetarë kanë nënshkruar kontrata pune?
A kanë sigurim të duhur social? Sa të larta janë
pagat e gazetarëve? A paguhen rregullisht?

Nuk ka të dhëna për numrin e kontratave të nënshkru-
ara nga viti 2019.⁶⁷ AGK e ka theksuar vazhdimisht proble-
min e mungesës së kontratave të punës për punon-
jësit medial, duke konsideruar që kjo është shkelje Ligjit
të Punës dhe krijon një gjendje të pasigurisë financiare

58 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

59 Gentiana Begolli Pustina, Kryetare e Bordit të AGK-së, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 17.11.2020.

60 Komisioni i Pavarur për Media, "KPM-2010/01 Kodi i sjelljes për shërbimet mediale audiovizuale në Republikën e Kosovës", Prishtinë: 2010, qasur më 13.10.2020, http://kpm-ks.org/assets/cms/uploads/files/Leqjisjacioni/1292592101.0176.pdf?fbclid=IwAR058gwIKGyTSbvAri_12Cx5relkTguLTUQfDHI_Pwhc63KYVvEwdnPwPeo

61 AGK, "Pas ankesave nga AGK dhe shoqëria civile, KPM-ja pezullon procesin e ndryshimit të Kodit të Etikës", Prishtinë: 2020, qasur më 11.03.2020, <http://agk-ks.org/en/following-complaints-from-gjk-and-civil-society-ims-suspends-the-process-of-amending-the-code-of-ethics/>

62 IKD, "Kuvendi i Kosovës dhe Mediat punojnë për ta informuar më mirë publikun", Prishtinë: 2019, qasur më 15.01.2021, <https://www.ndi.org/our-stories/kosovo-parliament-and-media-work-better-inform-public>

63 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Roli i Medias dhe publikut në punën e Kuvendit", qasur më 24.02.2021, <https://www.kuvendikosoves.org/en/about-the-assembly/role-of-media-and-public-in-the-work-of-the-a/>

64 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

65 Kuvendi i Republikës së Kosovës, "Roli i Medias dhe publikut në punën e Kuvendit", qasur më 24.02.2021.

66 Ibid.

67 Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, "Situaata e punëtorëve medial në Republikën e Kosovës", qasur më 15.02.2021, <https://mpms.rks-qov.net/raportohet-mbi-gjendjen-e-punetoreve-medial-ne-kosove/>

për punonjësit medial.⁶⁸ Gazetarët e Transmetuesit Publik punojnë pa sigurim social që nga viti 2016⁶⁹ ashtu si shumica e punonjësve medial në mediat private ku disa gazetarë e paguajnë vetë sigurimin social.⁷⁰ Vetëm gazetarët nga transmetuesi publik dhe disa media kryesore paguhen rregullisht, ndërsa të tjerët ende ballafaqohen me vonesa në pagesa. Ka edhe raste kur disa punonjës medial paguhen në para të gatshme. Paga mesatare e gazetarëve dhe punonjësve të tjerë medial është nën mesataren e vendit.⁷¹

Dy anketa të realizuara nga AGK në vitin 2020 vunë në pah që pandemia i ka prekur më shumë punonjësit medial me paga më të ulëta, sidomos ata që marrin pagë minimale nga 130 deri në 250 Euro. Sipas këtyre anketave të realizuara nga AGK për periudhën para dhe gjatë pandemisë, 22 prej 120 të anketuarve janë përgjigjur që paga e tyre mujore sillet mes 130 deri në 250 Euro, ndërsa në anketën vijuese numri i tyre u rrit në 38, pas përhapjes së pandemisë. Ndërkohë, është rritur edhe numri i punonjësve medial që deklaruan se janë paguar mbi 250 Euro pas pandemisë. Prej 24 të anketuarve që kanë thënë se paguhen mes 260 dhe 350 Euro para pandemisë, në periudhën pas pandemisë, numri i tyre ra në 20. Po ashtu u zvogëlua numri i pu-

68 AGK, "AGK dhe Inspektorati i Punës me nismë dymujore për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve", Prishtinë: 2019, qasur më 15.02.2021, <http://agk-ks.org/agk-dhe-inspektorati-i-punes-me-nisme-dy-mujore-per-mbrojtjen-e-te-drejtave-te-gazetareve/>

69 Tre grupe fokusit me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliq Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

70 Ibid.

71 Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), "Niveli i pagës në Kosovë 2019-2020", Prishtinë: 2019, qasur më 15.02.2021, <https://ask.rks-gov.net/en/kosovo-agency-of-statistics/add-news/wage-level-in-kosovo-2012-2019>

nonjësve medial që paguhen prej 360 në 500 Euro, nga 35 para pandemisë në 30 pas saj. 21 të anketuar deklaruan që para pandemisë paguheshin nga 500 në 650 Euro, ndërsa pas pandemisë numri i tyre ra në 17. Madje, edhe numri i atyre që paguhen më shumë se 650 Euro ka rënë, nga 18 para pandemisë në 15 pas saj. Këto shifra tregojnë që pandemia i ka prekur më shumë punonjësit medial me paga më të vogla, duke ndikuar në rritjen e numrit të atyre që marrin pagë minimale prej 130 në 250 Euro. Një numër i konsiderueshëm i punonjësve medial deklaruan në anketë që zvogëlimi i pagave ishte pasojë e zvogëlimit të detyruar të orarit të punës dhe vështirësive financiare të mediave ku punojnë.⁷²

Në çfarë gjendje janë kushtet e punës së gazetarëve? Cilat janë problemet më të mëdha me të cilat përballen ata në vendin e punës?

Sfidat kryesore për gazetarët në vendin e punës mbeten mungesa e sigurisë në punë dhe pasiguria financiare të cilat u përkeqësuan në vitin 2020 për shkak të pandemisë. Transmetuesi Publik po ashtu sfidohet me hapësira të vogla të punës, pasi që punojnë në një ndërtesë të marrë me qira nga qeveria, e cila nuk i përmbush nevojat as kapacitetet e tyre.⁷³ Për gazetarët nga mediat private, sidomos portalet e lajmeve, kuota e lartë e lajmeve që duhet të jepen është në mesin e sfidave kryesore me të cilat ballafaqohen, si dhe presioni për të publikuar më herët e më shpejt që ndikon negativisht në cilësinë e gazetarisë në sektorin online.⁷⁴

B2 Pavarësia editoriale në mediat private

A kanë miratuar mediat private dokumente organizative sipas të cilave redaksitë mbahen të ndara dhe të pavarura nga menaxherët dhe departamentet e marketingut? A kanë miratuar rregulla të tjera për ta mbrojtur pavarësinë editoriale nga pronarët e mediave dhe organet menaxhuese? A respektohen ato rregulla?

Disa prej mediave në Republikën e Kosovës kanë miratuar dokumente organizative sipas të cilave redaksitë duhet të mbahen të ndara dhe të pavarura nga menaxherët dhe departamentet e marketingut. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që sektorët e menaxhmentit dhe marketingut nuk ushtrojnë ndikim në përmbajtjen editoriale, pasi që konsiderohet se mediat si biznese janë duke bërë të pamundurën për t'i siguruar të ardhurat e tyre.⁷⁵

A kanë redaksitë e mediave private kode të brendshme të etikës ose a i përmbahen ndonjë kodit të përgjithshëm të etikës?

Sa i përket kodit të brendshëm të etikës, mediat private u përmbahen dy kodeve. Raportimi etik i mediave të shkruara është i rregulluar me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës, që është një kod i përgjithshëm i etikës,⁷⁶ ndërsa për shërbimet e mediave audio-vizuale është një tjetër dokument vetërregullativ – Kodi i Mirësjelljes për shërbime të mediave audio-vizuale.⁷⁷

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që pronarët dhe menaxherët e mediave ushtrojnë mbi redaksitë apo gazetarët individualë?

Mungesa e kohës për të bërë hulumtime të plota e të hollësishme për shkak të presionit nga redaktorët dhe menaxhmenti për t'i rritur kuotat ditore është barra më e zakonshme e cekur nga gazetarët.

Në pyetjen për format më të zakonshme të presionit të ushtruar nga pronarët dhe menaxherët e mediave, disa prej gazetarëve që morën pjesë në njërin prej anketave të realizuara nga AGK, pohuan që presioni

72 AGK, "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameranëve dhe fotogazetarëve", Prishtinë: 2020, qasur më 27.11.2020, <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/IMPACT-OF-COVID-19-PANDEMIC-ON-THE-ECONOMIC-SITUATION-OF-JOURNALISTS-CAMERAMEN-AND-PHOTOJOURNALISTS.pdf>

73 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

74 Ibid.

75 Shkumbin Kajtazi, gazetar hulumtues, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 17.01.2021.

76 Këshilli i Mediave të Shkruara, "Kodi i Mediave të Shkruara të Kosovës", qasur më 13.10.2020, <http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2018/11/Press-Code-for-Kosovo-eng.pdf>

77 KPM, "Kodi i Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës", Prishtinë: 2016, qasur më 13.10.2020, https://www.kpm-ks.org/lajmi_i_plot/2297

i kohës është më i zakonshmi; presioni për të qenë të parët në publikimin e një ngjarjeje; presioni për të mos mbuluar biznese dhe persona të caktuar; cenzura dhe ndërhyrja gjatë mbulimit të temave të caktuara.

Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit të ushtruar nga pronarët e mediave ose menaxherët mbi redaksinë ose mbi ndonjë gazetar individual gjatë vitit të kaluar?

Nuk ka të dhëna për shembuj ilustrues të presionit ndaj gazetarëve gjatë periudhës së raportimit.⁷⁸ Megjithatë, pas miratimit të Pakos Emergjente Fiskale nga Qeveria e Kosovës, me qëllimin për të ofruar asistencë afatshkurtër financiare për menaxhimin e krizës, në muajt e parë pas shpërthimit të pandemisë, kishte raste kur mbulimi i pagave në shumën prej 170 Euro bëri që punëtorët medial ta pranohin pagën mujore të reduktuar për të njëjtën shumë, me arsyetimin e punëdhënësve se pjesa tjetër do të kompensohej nga Qeveria.⁷⁹

B3 Pavarësia editoriale në Transmetuesin Publik

A ka miratuar TSHP-ja kod të sjelljes dhe pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respekton gazetarët këtë kod?

Standardet profesionale dhe parimet etike të gazetarisë së Transmetuesit të Shërbimeve Publike janë të rregulluara me dokumente të brendshme.⁸⁰ Në anën tjetër, RTK ka edhe një komision disiplinor që është përgjegjës për trajtimin e çështjeve etike. Ky komision është parë si i anshëm nga disa gazetarë⁸¹ dhe, sipas tyre, në disa raste kanë shfaqur anshmëri dhe favoritizim.⁸²

78 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

79 AGK, "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në situatën ekonomike të gazetarëve, kameranëve dhe fotogazetarëve", Prishtinë: 2020, qasur më 27.11.2020, <http://aqk-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/THE-IMPACT-OF-COVID-19-PANDEMIC-ON-THE-ECONOMIC-SITUATION-OF-JOURNALISTS-CAMERAMEN-AND-PHOTOJOURNALISTS.pdf>

80 Radio Televizioni i Kosovës, "Standardet Profesionale dhe Parimet Etike të Gazetarisë në programet e Radio Televizionit të Kosovës", Prishtinë: 2015, qasur më 20.12.2020, https://www.rtklive.com/pages/files/standardet_profesionale.pdf

81 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

82 AGK, "Sulmet në media dhe organizata mediale, RTK Prishtinë", Prishtinë: 2020, qasur më 11.01.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/attacks-on-media-and-media-organizations-rtk-prishtina-05-04-2020/>

Është e rëndësishme të theksohet që redaktorët në TSHP tregojnë që Kodi i Etikës respektohet dhe stafi i redaksisë ka për detyrë të sigurojë që gazetarët e RTK-së punojnë në përputhje të plotë me standardet profesionale.⁸³

Cilat janë format më të zakonshme të presionit që qeveria i ushtron mbi redaksitë apo gazetarët individë në TSHP?

Gjatë periudhës raportuese nuk është ushtruar presion në redaksi apo gazetarë individë të TSHP-së.⁸⁴ Mënyra në të cilën funksionon RTK-ja nuk lë shumë hapësirë për presion nga Qeveria. Mundësia për presione ndaj RTK-së ka më shumë gjasa të vijë nga partitë politike, përfaqësuesit e të cilave janë në komisione parlamentare të cilat kanë ndikim në ekzekutimin e buxhetit tremujor të RTK-së përmes aprovimit të raporteve të TSHP-së.⁸⁵ Sipas disa gazetarëve, në rast se ka ndonjë presion ato bëhen vetëm ndaj redaktorëve dhe kryeredaktorëve. Megjithatë, nuk dihet për ndonjë rast të presionit nga Qeveria.⁸⁶

B4 Pavarësia editoriale në sektorin e mediave jo-fitimprurëse

A kanë miratuar mediat jofitimprurëse kod të sjelljes dhe pavarësisë editoriale të gazetarëve? A e respekton gazetarët këtë kod?

Sektori i mediave jo-fitimprurëse në Kosovë është më i vogël. BIRN,⁸⁷ KOSOVO 2.0⁸⁸ dhe Çohu,⁸⁹ janë mediat online më të shquara jo-fitimprurëse në Kosovë të cilat kanë zhvilluar kodin e mirësjelljes për gazetarët e tyre. Përveç kodit të etikës, BIRN ka zhvilluar edhe një kod kundër ngacimit seksual dhe rregullore të tjera të brendshme që e mbulojnë performancën e

83 Xhymret Veliu, Kryeredaktor në RTK1, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bajaj, 12.01.2021.

84 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

85 Ibid.

86 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

87 BIRN Kosovo, <https://birn.eu.com/network/birn-kosovo/>

88 Kosovo 2.0, <https://kosovotwopointzero.com/>

89 Çohu, <http://www.cohu.org/>

punonjësve.⁹⁰ BIRN Hub⁹¹ i monitoron këto rregullore dhe çdo vit bën një kontrollë të sigurisë dhe vlerësim të kërcënimeve në punë. BIRN ka një statut të organizatës të cilit i përmbahet kjo medie jofitimprurëse.⁹²

Cilat janë format më të zakonshme të presionit mbi mediat jofitimprurëse? Cili ishte shembulli më ilustrues i presionit të ushtruar mbi mediat jofitimprurëse?

Nuk ka të dhëna për presionin e ushtruar mbi mediat jo-fitimprurëse, megjithatë, gazetarja Jeta Xhara nga emisioni televiziv Jeta në Kosovë ishte viktimë e dy kërcënimeve verbale përmes mediave sociale gjatë vitit 2020.⁹³

B5 Liria e gazetarëve në procesin e prodhimit të lajmeve

Sa kanë liri gazetarët në përzgjedhjen e lajmeve në të cilat punojnë dhe se cilat aspekte të një storjeje duhet të theksohen?

Shkalla e lirisë që e kanë gazetarët në përzgjedhjen e storjeve është e kufizuar deri në një masë të caktuar. Siç pohuan shumica e gazetarëve që morën pjesë në diskutime, në përgjithësi, janë të lirë për të sugjeruar një storje. Megjithatë, kur vendoset se nga cila perspektivë do të mbulohet storja, atëherë liria e përzgjedhjes nga ana e gazetarëve është shumë më e kufizuar⁹⁴ Kjo është veçanërisht e zakonshme për gazetarët e mediave private, kur u duhet të raportojnë për persona dhe/ose tema që mund të kenë ndikim në media në biznes ose interes e tjera të pronarit të medias. Gazetarët, megjithatë, mendojnë se ka më

shumë vetëcensurim sesa ndikim të drejtpërdrejtë të pronarëve ose menaxherëve në mënyrën se si duhet të mbulohet një temë.

Sa shpesh marrin pjesë gazetarët në koordinimin e punëve në redaksi (pjesëmarrja në takime editoriale ose caktimi i reporterëve)?

Për shkak se gazetarët janë kryesisht ata që sjellin storje në mediat publike dhe private, ata marrin pjesë në koordinimin e redaksisë dhe dhomës së lajmeve. Megjithatë, mediat tradicionale mbajnë mbledhje editorial në baza ditore, në krahasim me mediat hulumtuese që në disa raste mbajnë mbledhje javore.⁹⁵

Cilat janë qëndrimet e gazetarëve në lidhje me etikën e gazetarëve?

Gazetarët e shohin rolin e tyre kryesisht si vëzhgues të distancuar, e jo si monitorues kritikë të Qeverisë dhe politikanëve.⁹⁶ Cilësia e lajmeve të prodhuara mbetet sfidë, pasi që nuk iu lë kohë të mjaftueshme për të bërë hulumtim të mirëfilltë që do t'iu mundësonte ta mbulonin një çështje në një mënyrë që do ta forconte rolin e tyre si vëzhgues të besueshëm dhe kritikues të personave në pushtet. Ky është kryesisht problem për gazetarët e portaleve të lajmeve online. Megjithatë, këtë problem nuk e kanë gazetarët hulumtues, pasi që ata kanë më shumë kohë për t'iu qasur një storjeje në mënyrën e duhur dhe kanë më shumë ndikim tek qytetarët.

Çfarë janë vetë-perceptimet e gazetarëve lidhur me masën në të cilën janë ndikuar nga rreziqe dhe burime të ndryshme të ndikimit?

Gazetarët që morën pjesë në diskutimet në fokus grupet pajtohen se ka ndikime të ndryshme në procesin e prodhimit të lajmeve, por shkalla në të cilën ato shprehen varet nga mediumi në fjalë dhe politika e tij editoriale. Në përgjithësi nuk mund të thuhet se nuk ka profesionalizëm ose që gazetarët nuk i dinë rregullat etike dhe profesionale. Përkundrazi, mund të thuhet se autocensura është e pranishme, d.m.th. gazetarët e dinë paraprakisht për cilat tema lejohen dhe për të cilat nuk lejohen të raportojnë. Sidoqoftë, një numër gazetarësh pohuan se janë të vetëdijshëm për disa tema që nuk mund t'i mbulojnë... ka disa biznese, performanca e të cilave nuk duhet të mbulohet, dhe e njëjta gjë vlen për disa persona, e gjithë kjo për shkak

90 Intervistë me Kreshnik Gashi, Kryeredaktor në BIRN Kosova, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.01.2021.

91 BIRN Hub është një subjekt ombrellë që koordinon punën e Rrjetit BIRN, një aleancë e organizatave vendore joqeveritare që promovon lirinë e fjalës, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike. Përderisa çdo organizatë vendore adreson nevojat vendore, BIRN Hub, e regjistruar në Bosnjë dhe Hercegovinë, zbaton programe rajonale, <https://birn.eu.com/network/birn-hub/birn-hub-about/>

92 Kreshnik Gashi, Kryeredaktor në BIRN Kosova, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 15.01.2021.

93 AGK, "Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve, Jeta Xhara, Xhemajl Rexha dhe Fidan Jupolli", dhe "Kërcënim verbal ndaj gazetares, Jeta Xhara", Prishtinë: 2020, qasur më 20.01.2021, <http://gqk-ks.org/en/rastet/other-threats-to-journalists-jeta-xhara-xhemajl-rexha-and-fidan-jupolli-prishtina-28-03-2020/> and <http://gqk-ks.org/en/rastet/verbal-threat-to-journalist-jeta-xhara-pristina-03-07-2020/>

94 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

95 Ibid.

96 Tre grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Getoarë Mulliqi Bojaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021.

të politikës editoriale”.⁹⁷ Prandaj, gazetari preferon të mos shkruajë për një temë, sesa të mbulojë temën në mënyrë joprofesionale ose të njëanshme.

Pra, vetë-cenzura konsiderohet si forma më e pranishme e ndikimit që e kanë raportuar të gjithë gazetarët, e jo presioni i drejtpërdrejtë nga organet menaxhuese ose pronarët e mediave.⁹⁸ Për disa gazetarë kjo nuk duket të jetë problem, pasi që pohojnë se e kanë ditur që nga fillimi cilat tema mund/do t'i mbulojnë derisa janë pjesë e mediave të caktuara. Gazetarët e vjetër janë kryesisht ata që janë të vetëdijshëm për kufizimet në mbulimin e një teme dhe thjeshtë i respektojnë ato kufizime.⁹⁹

B6 Pozita ekonomike e gazetareve

A punojnë gazetarët në kushte më të këqija pune në krahasim me kolegët e tyre meshkuj? A u ofrohen kontrata pune aq shpesh sa burrave?

Në përgjithësi, kushtet e punës të gazetareve në redaksi nuk janë ndryshe nga ato të gazetarëve. Nuk ka të dhëna lidhur me numrin e grave dhe burrave që kanë nënshkruar kontrata pune, por sipas disa vlerësimeve, në redaksi ka dukshëm më shumë gazetarë.¹⁰⁰

A priren gratë të mbajnë pozita drejtuese editoriale në redaksi, ashtu si burrat?

Nuk ka të dhëna të fundit statistikore për pozitat udhëheqëse editoriale në redaksi, por gazetarët janë më të prirura të mbajnë pozita editoriale në redaksi,¹⁰¹ sidomos në mediat kryesore, ndërsa gazetarët janë më shumë përgjegjës për sektorin menaxherial. Një dallim tjetër është vënë re sa i përket emisioneve kryesore televizive pasi që shumica e tyre udhëhiqen nga meshkuj dhe transmetohen gjatë kohës kryesore.

Sa janë të larta pagat e tyre në krahasim me ato të burrave?

Kontratat nuk janë diskriminuese në aspektin gjinor, pasi që pagat e gazetareve bazohen në performancën e tyre e jo në gjini. Dy anketa të kryera nga AGK në vitin 2020 treguan se pagat mesatare të gazetarëve ndryshojnë nga 250 në 350 euro¹⁰², dhe pagat e grave gazetare janë të njëjta me kolegët e tyre burra.

A i nënshtrohen presioneve specifike me baza gjinore?

Presioni me baza gjinore është prezent vetëm në rastet kur gazetarët janë shtatzëna dhe/ose pas kthimit në punë pas pushimit të lehonisë. Edhe pse Ligji i Punës iu garanton grave të largohen më herët vitin e parë pasi të kthehen në punë, ato nuk mund ta bëjnë këtë për shkak të natyrës së profesionit të tyre.¹⁰³

97 Ibid.

98 Ibid.

99 Ibid.

100 Ibid.

101 Ibid.

102 AGK, "Ndikimi i pandemisë COVID-19 në gjendjen ekonomike të gazetarëve, kameranëve dhe fotoreporterëve", Prishtinë: 2020, qasur më 27.05.2021, <http://agk-ks.org/wp-content/uploads/2020/10/THE-IMPACT-OF-COVID-19-PANDEMIC-ON-THE-ECONOMIC-SITUATION-OF-JOURNALISTS-CAMERAMEN-AND-PHOTOJOURNALISTS.pdf>

103 Tri grupe fokusi me gazetarë nga mediat e shkruara, transmetuesit, OJQ-të dhe mediat online të realizuara nga Gëtoarbë Mulliqaj Bajaj dhe Vesa Bala, 15.12.2020, 29.12.2020 dhe 11.01.2021



C1 Statistikat e sigurisë dhe mosndëshkimeve

Bazuar në rastet e raportuara gjatë vitit 2020, siguria e gazetarëve në Republikën e Kosovës nuk shënoi ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në krahasim me vitet e kaluara. Po ashtu, sipas Raportuesve pa Kufi, Kosova ka bërë progres në krahasim me vitin 2019¹⁰⁴ dhe 2018,¹⁰⁵ pasi që në vitin 2020 u rendit në vendin e 70 nga 180 vendet në renditjet botërore.¹⁰⁶

Në anën tjetër, numri i sulmeve fizike dhe kërcënimeve verbale në krahasim me vitin 2019 është rritur për tre raste, përderisa në krahasim me vitin 2018 numri i rasteve ishte pothuajse 30 % më i ulët. Në tre vitet e fundit, AGK regjistroi 62 raste të kërcënimeve ndaj gazetarëve dhe punëtorëve të tjerë medial, gjithsej 17 raste në vitin 2018, 21 raste në vitin 2019, 24 raste në vitin 2020. Situata me pandeminë, si dhe ngjarjet politike gjatë periudhës së raportimit ishin faktorët më domethënës që ndikuan negativisht në sigurinë e gazetarëve. Edhe pse numri i shtuar i rasteve të sulmeve është brenghosës, fakti që gazetarët janë më të hapur ndaj raportimit të rasteve konsiderohet ndryshim pozitiv.

104 Raportuesit pa Kufi, "2019 Indeksi i Lirisë Botërore të Shtypit", qasur më 11.01.2021, <https://rsf.org/en/ranking/2019#>

105 Raportuesit pa Kufi, "2018 Indeksi i Lirisë Botërore të Shtypit", qasur më 11.01.2021, <https://rsf.org/en/ranking/2018#>

106 Raportuesit pa Kufi, "2020 Indeksi i Lirisë Botërore të Shtypit", qasur më 11.01.2021, <https://rsf.org/en/kosovo>

Tabela 2: Numri i sulmeve të regjistruara ndaj gazetarëve në vitin 2020

Kategoritë	Numri	Përshkrimi
<p>Kërcënimet dhe ngacimimet jofizike Kërcënimet dhe ngacimimet jofizike përfshijnë: – mbikëqyrjen apo përcjelljen; – thirrje telefonike ngacmuese; – ngacimim arbitrar gjyqësor apo administrativ; – deklarata agresive nga zyrtarët publikë; – format e tjera të presionit që mund ta rrezikojnë sigurinë e gazetarëve në kryerjen e punës së tyre. Këto lloje të kërcënimeve nuk përfshijnë largimin e dhunshëm nga puna dhe ngacimim në vendin e punës</p>	11	<ul style="list-style-type: none"> – Gazetari Bekim Kabashi u kërcënua përmes Whatsapp nga biznesmeni Latif Kryeziu dhe prindërve të tij iu bë presion në shtëpinë e tyre nga një person. – Yllka Ahmetxhekaj e Periskopit u pengua nga policia derisa ishte në detyrë – Përpjekje për t'i vënë zjarr makinës së gazetarit Shkumbin Kajtazi – Ekipit të televizionit Klan Kosova iu ndalua hyrja në një sallë sporti – Gazetarja Jeta Xharra është sulmuar një herë e vetme nga Gani Koci – Jeta Xharra është sulmuar si pjesë e një grupi gazetarësh me Xhemajl Rexhën dhe Fidan Jupollin në mediat sociale – Arsim Lani i televizionit T7 u kërcënua përmes mesazheve në Facebook nga politikanja Melihate Tërmkollli – Zëvendës Ministri Enver Dugolli përdor gjuhë ofenduese ndaj gazetarëve – Adriatik Kelmendi, Agron Bajrami dhe Besnik Krasniqi linçohen përmes Facebook nga zyrtarë të Lëvizja Vetëvendosje – Fidan Jupolli ka marrë mesazhe kërcënuese për jetë në Facebook – Berat Buzhala nga Gazeta Express dhe Parim Olluri nga Insajderi janë sulmuar verbalisht nga Hysamedin Ferraj
<p>Kërcënimet ndaj jetës dhe sigurisë fizike të gazetarëve Këto mund të përfshijnë: – deklarata për vrasjen e gazetarëve, miqve të gazetarëve, familjes ose burimeve; – deklarata për dëm fizik ndaj gazetarëve, miqve të gazetarëve, familjes ose burimeve. Këto kërcënime mund të jenë: – bërë direkt ose përmes palëve të treta; – të dërguara përmes komunikimeve elektronike ose ballë për ballë; – mund të jetë implicite si dhe eksplicite.</p>	6	<ul style="list-style-type: none"> – Berat Buzhala nga Gazeta Express u sulmua nga disa persona të panjohur – Ekipi i RTK-së u kërcënua nga disa persona në uniforma me logo serbe në uniformat e tyre – Drejtori i TV Dukagjinit, Ermal Panduri mori një mesazh kërcënues për jetën në Facebook – Naser Gashi hyri me force në zyret e Gazetës Express dhe kërcënoi gazetarët – Sulmohet me plumba makina e gazetarit të Reporterit, Shkumbin Kajtazi – Valon Sylja, gazetar dhe pronar i Gazetës Metro u sulmua fizikisht nga një person
<p>Sulmet fizike ndaj gazetarëve Llojet e sulmeve fizike mund të përfshijnë dëmtime fizike ose mendore, rrëmbime, hyrje me dhunë në shtëpi / zyra, pajisje të sekuestruara, ndalim arbitrar, përpjekje të dështuara për vrasje, etj.</p>	4	<ul style="list-style-type: none"> – Ekipi i Arbresh.info u sulmua nga vozitësi i Kryetarit të Partisë Lista Serbe – Gazetarët Diamant Bajra dhe Nebi Maxhuni si dhe kamermani i tyre Arsim Rexhepi u sulmuan fizikisht nga dy persona në Mitrovicën e Veriut – Tatjana Lazarevic u arrestua nga policia edhe pasi ua tregoi ID-në e saj të shtypit – Nenad Mikulovic u sulmua fizikisht nga katër persona të maskuar
<p>Vrasjet e gazetarëve (në 15-20 vitet e fundit) Llojet e vrasjeve mund të përfshijnë vrasjen në shkëmbim armë zjarri, vrasje, vrasje me shpërthim bombe, rrahje për vdekje, etj.</p>	0	
<p>Kërcënimet dhe sulmet ndaj organizatave, institucioneve mediale, mediave dhe asociacioneve të gazetarëve Sulmet mbi pronën e mediave dhe organizatave, personelin e tyre, grabitje e pajisjeve, deklarata agresive nga zyrtarët publikë, etj. Gjithashtu, kërcënimet dhe sulmet mund të përfshijnë disa nga kategoritë e përmendura më sipër.</p>	3	<ul style="list-style-type: none"> – Gazeta ZËRI ua ndërpreu kontratën më shumë se 20 punëtorëve medial, pa njoftim paraprak – Organi udhëheqës i Transmetuesit Publik ka marrë masa selektive ndaj një grupi gazetarësh – Persona të panjohur e kanë kërcënuar RTK-në përmes telefonit

Në anën tjetër, sa i përket mosndëshkimit të sulmeve, situata mbetet e njëjtë, pasi që në 20 vitet e fundit autoritetet nuk i kanë hetuar në mënyrë të mirëfilltë rastet e gazetarëve të zhdukur dhe të vrarë në vend.

Sulmet dhe ngacmimet jofizike

Gjatë vitit 2020 ndodhën 11 raste të kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike ndaj gazetarëve në Kosovë. Kërcënimet dhe sulmet dallojnë mes atyre të afaristëve ndaj gazetarëve dhe punëtorëve të tjerë medial prej atyre të zyrtarëve shtetërorë si dhe të zyrtarëve të lartë të partive politike. Gazetari Bekim Kabashi i portalit Reporteri.net u kërcënua nga afaristi Latif Kryeziu,¹⁰⁷. Ndërsa gazetarja e portalit online Periskopi, Yllka Ahmetxhekaj u pengua derisa ishte në detyrë, nga një pjesëtar i Policisë së Kosovës gjatë kohës sa ishte duke raportuar gjatë izolimit në pandemi.¹⁰⁸ Këto raste u pasuan nga shembulli më i ashpër i kësaj natyre, ai i gazetarit Shkumbin Kajtazi të portalit Reporteri.net, ndaj të cilit u bë përpjekje për zjarrvënje të qëllimshme të veturës së tij, si dhe rasti i ekipit të televizionit Klan Kosova, i cili u pengua në punën e tij, duke iu ndaluar hyrja në një sallë sporti në Gjakovë.¹⁰⁹ Pjesa tjetër e kërcënimeve dhe ngacmimeve jofizike kanë të bëjnë me zyrtarë të lartë politikë, të cilët i kanë sulmuar gazetaret përmes mediave sociale. Gazetarja Jeta Xharra e emisionit “Jeta në Kosovë” u sulmua dy herë vitin e kaluar, në rastin e parë në lidhje me një postim në Facebook, ku Jeta Xharra, Xhemajl Rexha dhe Fidan Jupolli u quajtën mercenarë të partisë politike Lëvizja Vetëvendosje,¹¹⁰ dhe rasti tjetër ishte me zyrtarin e lartë të partisë politike PDK, Gani Koci, i cili e quajti atë grupë septike.¹¹¹

Kërcënimet për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve

Janë gjashtë raste të kërcënimeve për jetën dhe sigurinë fizike të gazetarëve. Kërcënimi i parë fizik i vitit 2020 ishte kundër gazetarit Berat Buzhala të

portalit online Gazeta Express, i cili u sulmua fizikisht nga disa persona derisa po priste në rend në një barnatore.¹¹² Kërcënimi i dytë i vitit 2020 ndodhi në Zubin Potok, ku disa persona në uniforma me logo serbe e kërcënuan ekipin e RTK-së¹¹³ që u pasua me një koment kërcënues për jetë në Facebook drejtuar gazetarëve, si dhe drejtorit të TV Dukagjini.¹¹⁴ Rastet e tjera që janë poashtu shumë të ashpra dhe kërcënojnë klimën e ushtrimit të gazetarisë në Kosovë janë goditja me plumba e makinës së Shkumbin Kajtazit, gazetarit të portalit Reporteri.net, në Mitrovicë, derisa ndodhej në një lokal të afërm në qytetin e tij të lindjes.¹¹⁵ Dhe në fund, por jo më pak i rëndësishëm, sulmi fizik ndaj Valon Sylës, gazetar dhe pronar i portalit online Gazeta Metro, ku gazetari u sulmua fizikisht nga një person për shkak të disa postimeve të tij në Facebook.

Numri i sulmeve fizike

Gjatë vitit 2020 ndodhën gjithsej katër sulme fizike ndaj gazetarëve. I pari ishte ndaj ekipit të portalit online Arbëresh.info, nga vozitësi i Kryetarit të partisë Lista Serbe (Srpska Lista), Slavko Simic,¹¹⁶ ndërsa tri sulme të tjera ndodhën në Mitrovicën Veriore. Gazetarët Diamant Bajra dhe Nebi Maxhuni, si dhe kamermani i portalit online Arsim Rexhepi u sulmuan fizikisht nga dy persona derisa po realizonin një storje mbi pandeminë. Gazetarit Maxhuni pastaj iu desh të merre trajtim mjekësor.¹¹⁷ Policia e arrestoi Tatiana Lazarevic nga portali “Kossev” edhe pse ia kishte treguar policinë ID-në e saj. Ajo po punonte në terren në lidhje me një storje për Qendrën e Kujdesit Shëndetësor në Zvečan. Edhe pse vendimi i qeverisë së Kosovës nuk vlente për gazetaret, Lazarevic u dërgua në stacion.¹¹⁸ Përveç kësaj, sulmi i fundit fizik ishte ndaj Nenad Mikulovic, afër banesës së tij nga katër persona të maskuar. Gazetari dhe pronari i Televizionit

107 AGK, “Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve, Bekim Kabashi, Rahovec”, Prishtinë: 2020, qasur më: 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/other-threats-to-journalists-bekim-kabashi-rahovec12-03-2020/>

108 AGK, “Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve, Yllka Ahmetxhekaj”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/other-threats-to-journalists-yllka-ahmetxhekaj-prishtine-05-05-2020/>

109 AGK, “Pengimi i ekipit të Klan Kosovës”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/obstruction-of-klan-kosova-team-gjakove-12-11-2020/>

110 AGK, “Kërcënime të tjera ndaj gazetarëve, Jeta Xharra, Xhemajl Rexha dhe Fidan Jupolli”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/other-threats-to-journalists-jeta-xharra-xhemajl-rexha-and-fidan-jupolli-prishtina-28-03-2020/>

111 AGK, “Kërcënim verbal ndaj gazetares Jeta Xharra”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/verbal-threat-to-journalist-jeta-xharra-prishtina-03-07-2020/>

112 AGK, “Kërcënim tjetër me jetë ndaj gazetarëve, Berat Buzhala”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/threats-against-the-lives-and-limbs-of-journalists-berat-buzhala-prishtina-21-03-2020/>

113 AGK, “Pengimi i ekipit të RTK-s”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/obstruction-of-rtk-team-zubin-potok-14-08-2020/>

114 AGK, “Kërcënime të tjera ndaj gazetarit Ermal Panduri”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/other-threats-towards-journalist-ermal-panduri-08-09-2020/>

115 AGK, “Kërcënim me jetë ndaj gazetarëve, Shkumbin Kajtazi”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/actual-attack-on-journalist-shkumbin-kajtazi-mitrovica18-10-2020/>

116 AGK, “Sulmet fizike ndaj gazetarëve, arbresh.info team”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/actual-attacks-on-journalists-arbresh-info-team-vucitrin10-01-2020/>

117 AGK, “Sulmet fizike ndaj gazetarëve, Diamant Bajra, Nebi Maxhuni dhe Arsim Rexhepi”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/actual-attacks-on-journalists-diamant-bajra-nebi-maxhuni-and-arsim-rexhepi-north-mitrovica-23-03-2020/>

118 AGK, “Sulmet fizike ndaj gazetarëve”, Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://aqk-ks.org/en/rastet/actual-attacks-on-journalists-tatiana-lazarevic-mitrovica-12-04-2020/>

Plus mori trajtim mjekësor për shkak të lëndimeve trupore.¹¹⁹

Numri dhe llojet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj institucioneve të mediave, organizatave, asociacioneve të mediave dhe të gazetarëve.

Në bazën e të dhënave të AGK-së gjatë vitit të kaluar u regjistruan tre raste si kërcënime dhe sulme ndaj institucioneve, organizatave mediale, mediave dhe asociacioneve të gazetarëve. Rasti i parë ka të bëjë me krizën ekonomike të shkaktuar nga pandemia COVID-19 në Republikën e Kosovës si pasojë e së cilës menaxhmenti i Gazetës ZËRI largoi nga puna 20 punëtorë, tre gazetarë dhe një redaktor, prej të cilëve dy gazetarë ishin shtatzëna, pa njoftim paraprak. Ndërprerja e kontratave të punës nga punëdhënësi, që u dënua edhe nga AGK-ja,¹²⁰ ishte një shkelje e drejtpërdrejtë e Ligjit të Punës të Kosovës.¹²¹ Dy rastet e tjera kanë të bëjnë me Transmetuesin Publik RTK. Rasti i parë ndodhi në fillim të përhapjes së pandemisë në Kosovë dhe përfshiu RTK-në, transmetuesin publik, organet udhëheqëse të të cilit morën masa selektive disiplinore ndaj një grupi gazetarësh që shprehën pakënaqësinë e tyre.¹²² Ndërkohë, rasti i fundit ka të bëjë me një kërcënim që u bë nga persona të panjohur. Policia është lajmëruar për këtë rast dhe i kanë marrë hapat e nevojshëm.¹²³

C2 Sjellja e institucioneve shtetërore dhe akterëve politikë lidhur me mbrojtjen e gazetarëve

A ka dispozita specifike në ligjet ose mekanizmat e tjerë që e mbështesin sigurinë e gazetarëve, si në terren (offline) ashtu edhe online?

Ekzistojnë dispozita ligjore, si ajo e Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në fuqi nga 14 prilli 2019) që e mbrojnë çdo person i cili mund të jetë viktimë e veprave penale për shkak të punës së tij/saj. Ekziston edhe Ligji Nr. 04 / L-137 për Mbrojtjen e burimeve të gazetarëve, i datës 31 korrik 2013.¹²⁴ Sidoqoftë nuk janë hartuar politika të veçanta nga institucionet shtetërore që i mbrojnë gazetarët në veçanti. Në vitin 2019, AGK nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK), me qëllim që anëtarët e AGK-së të marrin ndihmë juridike falas. Në vitin 2020, OAK u tërhoq nga ky MM në mënyrë të njëanshme, duke i lënë gazetarët dhe punëtorët e tjerë medial të pambrojtur, sidomos gjatë pandemisë.¹²⁵

A ka dokumente (protokolle, rregullore të punës, etj.) që janë miratuar nga institucionet shtetërore të cilat u japin udhëzime shtesë ushtrisë dhe policisë se si të sillen me gazetarët?

Policia e Kosovës (PK) ka caktuar një Koordinator që i monitoron dhe përcjell të gjitha rastet që përfshijnë gazetarët. Të gjitha veprimet e marra nga ky institucion i sigurisë realizohen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me organet tjera kompetente. Sa i përket sigurisë së gazetarëve, Prokurorët dhe Gjykata Themelore në Prishtinë poashtu kanë caktuar koordinator për mbledhjen e të dhënave në rastet që përfshijnë gazetarët.¹²⁶

119 AGK, "Sulmet fizike ndaj gazetarëve, Nenad Milenkovic", Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://agk-ks.org/en/rastet/actual-attacks-on-journalists-nenad-milenkovic-northern-mitrovica-28-04-2020/>

120 AGK, "AGK: Largimi nga puna i punëtorëve medial nga Gazeta Zëri është i papranueshëm", Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://agk-ks.org/en/ajk-the-laying-off-of-media-workers-from-zeri-newspaper-is-unacceptable/>

121 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, "Ligji Nr. 03/L –212 i Punës", Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <https://gzk.rks-gov.net/ActiDocumentDetail.aspx?ActiD=2735>

122 AGK, "Sulmet ndaj mediave dhe organizatave të mediave, RTK", Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://agk-ks.org/en/rastet/attacks-on-media-and-media-organizations-rtk-prishtina-05-04-2020/>

123 AGK, "Kërcënim verbal ndaj RTK-së", Prishtinë: 2020, qasur më 18.02.2021, <http://agk-ks.org/en/rastet/verbal-threat-towards-rtk-pristina-05-09-2020/>

124 Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqaj Bajaj, 12.01.2021.

125 AGK, "OAK tërhoqet në mënyrë të njëanshme nga MM me AGK-në, duke i lënë gazetarët pa mbrojtje ligjore", qasur më 18.02.2021, <http://agk-ks.org/en/kba-unilaterally-withdrawals-from-the-mou-with-ajk-leaving-the-journalists-without-legal-protection/>

126 Koha Ditore, "Gjykata Themelore në Prishtinë emëron një koordinator për rastet e gazetarëve", Koha Ditore web page, 18.06.2018, qasur më 18.02.2021, <https://www.koha.net/arberi/99940/gjykata-themelore-ne-prishtine-emeron-koordinator-per-rastet-e-gazetarëve/>

A ka ndonjë mekanizëm për monitorimin dhe raportimin e kërcënimeve, ngacmimeve dhe dhunës ndaj gazetarëve? A publikojnë institucionet shtetërore të dhëna në lidhje me sulmet ndaj gazetarëve dhe mosdëshkueshmërinë?

Ka mungesë të mekanizmave shtetërorë për monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave për kërcënimet dhe sulmet ndaj gazetarëve dhe organizatave mediale. Aktualisht, sistemi gjyqësor po kalon nëpër një tranzicion përmes zhvillimit të Sistemit Informatik për Menaxhimin e Rasteve (SIMR) i cili do të konsolidojë të dhëna dhe do të ofrojë përcjellje të rasteve gjyqësore. Megjithatë, ende nuk është e qartë se a do të konsolidojë SIMR të dhëna nga policia. Në anën tjetër, PK, bazuar në procedurat e brendshme të saj, raporton dhe publikon në baza ditore për të gjitha rastet, duke përfshirë ato që përfshijnë gazetarët. Megjithatë, digjitalizimi i bazës së të dhënave është në proces përmes të cilit informatat do të gjenerohen në bazë të profesionit të palëve në procedura.¹²⁷ Rastet e sulmeve ndaj gazetarëve raportohen në AGK, që avokon në emrin e tyre, si dhe në Polici dhe në Prokurori të cilat marrin masat e nevojshme për t'i hetuar këto raste.

A njihen sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve nga institucionet shtetërore si shkelje e lirisë së shprehjes dhe ligjit penal? A japin zyrtarët qeveritarë deklarata të qarta duke i dënua sulmet ndaj gazetarëve?

Institucionet qeveritare i njohin sulmet ndaj sigurisë së gazetarëve si cenim të lirisë së shprehjes, ligjit për të drejtat e njeriut dhe ligjit penal, por zyrtarët publikë përmbahen nga dhënia e deklaratave, vetëm nëse ka sulme fizike ndaj gazetarëve dhe/ose reagime nga asociacioni i gazetarëve, organizatat e shoqërisë civile apo vëzhguesit ndërkombëtarë të lirisë së mediave.

A bashkëpunojnë institucionet shtetërore me organizatat e gazetarëve për çështjet e sigurisë së gazetarëve? Bazuar në rëndësinë e bashkëpunimit mes PK-së dhe AGK-së, që pastaj kontribuon në mbrojtje të gazetarëve gjatë kryerjes së punës së tyre, të dy palët e panë të nevojshme të lidhin një marrëveshje bashkëpunimi, e cila do ta përmirësonte efikasitetin e këtyre dy subjekteve.¹²⁸ Kjo marrëveshje do të

ndikonte drejtpërdrejtë në parandalimin e sulmeve ndaj gazetarëve si dhe në procedimin e rasteve.¹²⁹

Në rastet e mbikëqyrjes elektronike, a e respektojnë institucionet shtetërore lirinë e shprehjes dhe privatësinë? Cili ishte rasti më i fundit i mbikëqyrjes elektronike mbi gazetarët?

Mbikëqyrja elektronike në Kosovë lejohet përmes Kodit Penal¹³⁰ dhe Kodit të Procedurës Penale,¹³¹ me kusht që të sigurohet një urdhër. Ky urdhër jepet vetëm për raste të kërcënimit të lartë. Gjatë periudhës së raportimit, nuk kishte të dhëna të disponueshme për raste të mbikëqyrjes elektronike të gazetarëve në Kosovë.

C3 Sjellja e sistemit të drejtësisë penale dhe civile në lidhje me kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve

A ka njësi specifike brenda institucioneve të sistemit të drejtësisë civile kushtuar hetimeve dhe ndjekjeve penale ndaj kërcënimeve dhe akteve të dhunës ndaj gazetarëve?

Në sistemin e drejtësisë në Kosovë nuk ka institucione/ njësi specifike të dedikuara për hetime, ndjekje penale, mbrojtje dhe kompensim për të siguruar sigurinë e gazetarëve dhe për ta adresuar çështjen e mosndëshkimit.

A ofrojnë zyra e Prokurorit Publik dhe Ministria e Punëve të Brendshme burime të përshtatshme për t'i mbuluar hetimet mbi kërcënimet dhe aktet e dhunës ndaj gazetarëve?

Institucionet relevante shtetërore nuk sigurojnë burime adekuate për t'i mbuluar hetimet dhe masat e mbrojtjes që iu ofrohen gazetarëve janë joadekuate. Sidoqoftë, brenda programeve të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) zhvillohen projekte për ngritjen e kapaciteteve profesionale për gazetarët brenda një "seksioni mediatik".

127 Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.01.2021.

128 Gentiana Begolli Pustina, Kryetare e Bordit të AGK-së, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 17.11. 2020.

129 MIM i hartuar dhe i ndarë me zyrën e PK-së për shtyp dhe informim publik. Memorandumi i Mirëkuptimit mes AGK-së dhe PK-së do të nënshkruhet sapo të qartësohet dokumenti nga zyrat ligjore të të dyja subjekteve.

130 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës "Kodi Penal i Republikës së Kosovës", qasur më 13.01.2021, <https://mj.rks-gov.net/desk/inc/media/A5713395-507E-4538-BED6-2FA2510F3FCD.pdf>

131 Ibid.

A hetohen krimet kundër gazetarëve, përfshirë frikësimet dhe kërcënimet, në mënyrë të menjëhershme, të paanshme dhe me efikasitet? A ka masa të mbrojtjes që u ofrohen gazetarëve si reagim ndaj kërcënimeve për sigurinë e tyre fizike?

PK është institucioni më efektiv sa i përket reagimeve në rastet që përfshijnë gazetarët.¹³² Rastet që kanë të bëjnë me sulmet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve mbulohen përmes neneve të ligjeve të caktuara të cilat nuk specifikojnë profesionin e viktimës.¹³³ PK ka marrë masa për mbrojtjen e integritetit fizik të gazetarëve të kërcënuar duke ofruar edhe mbrojtje të afërt në raste të caktuara.¹³⁴ Prokuroria ka caktuar një Prokuror për rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, si dhe një bazë të dhënash ku klasifikohen këto raste. Sidoqoftë, këto raste zakonisht zgjaten dhe nuk hetohen menjëherë. Praktikrat e mëvonshme në lidhje me reagimin e institucioneve të tjera, përveç Policisë së Kosovës ndaj rasteve të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, dhe mos sigurimi i mbrojtjes së nevojshme të garantuar me ligj, e përkeqëson situatën e gazetarëve.¹³⁵ Megjithatë, rastet që marrin vëmendje të lartë mediatike tentojnë të merren më seriozisht dhe të hetohen shpejt, siç është rasti i ish-Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, i cili e sulmoi fizikisht një gazetar në vitin 2019.¹³⁶

Në rastet e vendimeve të formës së prerë, a imponohen sanksione vetëm për autorët e veprës apo edhe për nxitësit / ideatorët?

Në rastet e vendimeve të formës së prerë, vendimet merren në bazë të dëshmive dhe vlejën si për autorin e krimit dhe/ose për ideatorin.¹³⁷

A organizojnë institucionet trajnime të përshtatshme për policinë, prokurorët, avokatët dhe gjyqtarët në lidhje me mbrojtjen e lirisë së shprehjes dhe gazetarët? A i organizojnë ata këto trajnime në bashkëpunim me asociacionete gazetarëve?

Akademia e Drejtësisë gjatë tërë vitit organizon trajnime për prokurorët dhe gjykatësit për lirinë e shprehjes. IKD gjatë fazës së raportimit mbajti trajnime për avokatët, gjykatësit dhe prokurorët për lirinë e shprehjes, lirinë e medias, si dhe për të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.¹³⁸ PK ka organizuar trajnime në lidhje me mediat me pjesëmarrje të një numri zyrtarësh policorë, përmes të cilave i ka shtuar kapacitetet e brendshme për punë kompetente me mediat. Prokurorë dhe koordinatorë të caktuar, zëdhënës, administratorë të prokurorive, bashkëpunëtorë profesionalë dhe zyrtarë të tjerë, kanë marrë pjesë në trajnime për marrëdhëniet me mediat, të mbështetura kryesisht nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, megjithëse ka ende nevojë për trajnime të mëtejshme.¹³⁹

¹³² Betim Musliu & Ehat Miftaraj, përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 20.12.2020.

¹³³ Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.01.2021.

¹³⁴ Shkumbin Kajtazi, gazetar hulumtues, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 17.01.2021.

¹³⁵ Betim Musliu & Ehat Miftaraj, përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 20.12.2020.

¹³⁶ Pristina Insight, "Ministri akuzohet për sulm ndaj gazetarit", qasur më 14.04.2021, <https://pristinainsight.com/%20minister-accused-of-assaulting-journalist/?fbclid=...>

¹³⁷ Besnik Ramosaj, Drejtor i Departamentit të Statistikave në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 13.01.2021.

¹³⁸ Betim Musliu & Ehat Miftaraj, përfaqësues të Institutit të Kosovës për Drejtësi, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 20.12.2020.

¹³⁹ Besim Kelmendi, Prokuror i Shtetit, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës, intervistuar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, 12.01.2021.

Tabela 3: Pasqyrë e aktiviteteve të përfundura për zgjidhjen e disa prej sulmeve më të rënda ndaj gazetarëve në pesë vitet e fundit

Case	Year	2016	2017	2018	2019	2020
1. Sulm fizik ndaj Ensar Ramadanit (17.12.2019)					18.12.2019 – Prokurori i Shtetit hapi hetimet për rastin. 10.02.2020 – Sulmuesi u padit për sulm nga Gjykata Themelore në Prishtinë.	
2. Kërcënime ndaj Bujar Vitijajt reporter në portalin Shneta					8.10.2019 – Gjykata Themelore e Prishtinës e gjobiti kundërvajtësin me 200 euro.	
3. Kërcënime ndaj to Taulant Osmanit reporter i Kallxo.com (11.11.2017)			13.11.2017 – Gjykata Themelore në Gjilan vendosi urdhër ndalimi për M.N. për kërcënimin e gazetarit.			
4. Më 02.04.2019 një gazetar u kërcënua nga një imam në Pejë					– Krimi është raportuar – Prokuroria e ka marrë rastin – Prokuroria e ka dërguar në gjykatë – Gjykata e ka miratuar kërkesën – Gjykata ka inicuar masa hetuese	
5. On 13.06.2020 Shkumbin Kajtazi's car was subject of arson attempt.						22.03.2021 – Gjykata Themelore në Mitrovicë e akuzoi kundërvajtësin me 10 muaj burg efektiv dhe 20 Euro për shpenzimet gjyqësore.
6. Më 18.10.2020 vetura e Shkumbin Kajtazi u sulmua me armë zjarri.						– Krimi është raportuar – Prokuroria e ka marrë rastin – Rasti është nën hetim
7. Më 22.12.2020 gazetari Valon Sylja u sulmua fizikisht.						Gjykata Themelore e Prishtinës ka shpallur aktgjykimin ndaj të akuzuarit, për veprën penale "Lëndim i lehtë trupor", nga Neni 185 par. 1, nënpar. 1.4 i Kodit Nr. 06 / L-074 të CCRK-së. I akuzuari u shpall fajtor për këtë veprë penale dhe u gjobit me 4,500 (katër mijë e pesëqind) euro, të cilat ishte i detyruar t'i paguante brenda 15 ditëve pas vendimit përfundimtar. Koha e kaluar në paraburgim, nga 22.12.2020 deri më 06.01.2021, do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Përfundime dhe rekomandime

Ky studim kishte për qëllim ta hulumtonte shtrirjen e mediave sa i përket lirisë dhe sigurisë së gazetarëve në Kosovë dhe për të parë se a ofron konteksti socio-ekonomik dhe politik brenda vendit një mjedis të favorshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të medias në këtë aspekt. Raporti mbulon çështjet nga konteksti i vitit 2020 dhe bazohet në raportet e mëparshme të realizuara rreth kësaj teme.

Të gjeturat tregojnë që nuk është arritur progres, pasi që korniza ligjore konsiderohet mjaft gjithëpërfshirëse, sepse është e strukturuar edhe për ta mbështetur zhvillimin e sektorit të medias dhe gazetarët. Studimi gjeti që ende ka sfida sa i përket zbatimit. Organi rregullativ KPM dhe organi vetë-rregullativ KMSHK në përgjithësi konsiderohen si efektiv por zbatimi i mandatit të tyre sfidohet në mungesë të burimeve adekuate. Mekanizmat e mbledhjes së të dhënave për monitorimin adekuat dhe referimin e rasteve të shpifjes dhe fyerjes kanë mungesë të përcjelljes së duhur të efektivitetit të institucioneve gjyqësore për t'i regjistruar çështjet e ngritura para tyre. Kjo për shkak të mungesës së një mekanizmi të duhur, që do të vendoset përmes SMIR i cili do të funksionalizohet. SMIR do të mundësojë ndarjen dhe gjurmimin kronologjik të të dhënave. Gazetarëve iu garantohet e drejta e asociimit dhe liria për të formuar sindikata. Ata përfaqësohen nga dy Asociacione, AGK dhe AGSK, por aktualisht ekzistojnë vetëm tri sindikata dhe të gjitha brenda TSHP-së. Mungesa e një sindikate që i përfaqëson interesat e të gjithë gazetarëve për të mbrojtur të drejtat e punës në Kosovë ka bërë që AGK përgjithësisht të shërbejë si organi kryesor avokues për mbrojtjen e të drejtave të gazetarëve.

Në studim u shfaq një dakordim mjaft i njëanshëm për kushtet e këqija ekonomike të gazetarëve, të tilla si mungesa e përgjithshme e kontratave ose kontratat afatshkurtra, pagat e ulëta dhe pagesa e tyre e rrallë, kushtet e këqija të punës, për të përmendur vetëm disa dhe përdorimi i këtyre kushteve për të të ushtruar presion mbi gazetarët. Gazetarët janë shumë më pak të përfaqësuara në emisionet që shfaqen në kohën kryesore, si dhe në pozitat menaxheriale në redaksi. Presioni nga kuotat ditore rezulton në raportim të paverifikuar dhe përhapje të keqinformimit ndërsa, njëkohësisht, vetëcenzura konsiderohej si një nga ndikimet më të mëdha indirekte. Disa media private ende nuk kanë kod të mirësjelljes. Vetë pavarësia editoriale në disa nivele ndikohet nga vetë-cenzura. Përderisa gazetarët raportuan që janë të lire të zgjedhin storje, ata janë të vetëdijshëm për këndvështrimet që mund të paraqesë ajo storje.

Gjatë vitit 2020 u rrit numri i kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, numër i cili u rrit në 24 raste të raportuara. Në vitin 2018 u raportuan 17 raste, ndërsa në vitin 2019 ishin 21 raste. Megjithatë, rritja e raportimit të rasteve mund të interpretohet si një hap drejt ndryshimit pozitiv pasi që gazetarët ndihen më të sigurt për t'i raportuar rastet e kërcënimeve dhe sulmeve. Përderisa numri i sulmeve të raportuara është rritur, studimi konstatoi që institucioneve shtetërore dhe akterëve politikë ende iu mungojnë burimet e nevojshme për ta trajtuar situatën e gazetarëve në sistemet e gjykatave. Përkundër kësaj, përpjekjet për përmirësimin e situatës janë të qarta, pasi që është bërë caktimi i koordinatorëve për mbledhjen e të dhënave për rastet e gazetarëve nga Prokurorët dhe Gjykata Themelore e Prishtinës si dhe zhvillimi i SIMR-së që është në proces dhe do të mundësojë monitorimin, referimin, ndarjen dhe përcjelljen kronologjike të rasteve.

REKOMANDIME

Legjislacioni i Mediave në përgjithësi – me hapësira për përmirësim – konsiderohet si gjithpërfshirës me shkathësitë e duhura për të mundësuar zhvillimin dhe funksionimin e sektorit të medias dhe mekanizmave të tij. Mjedisi që mundëson zbatimin e tij po dobësohet dhe duhet të përforcohet. Rekomandimet që kanë dalë nga gjetjet e studimit janë si në vijim:

- Të sigurohet qëndrueshmëria dhe llogaridhënia e TSHP-së për ta shtuar paanësinë, për ta ulur ndikimin politik dhe për ta mbrojtur pavarësinë e tij në pajtim me statusin e tij.
- Stabiliteti financiar: RTK duhet të trajtohet si institucion publik dhe duhet të identifikohen metodat e duhura për financimin e tij.
- Emërimi i Bordit të RTK: Paanshmëria politike duhet të përforcohet brenda RKT-së. Duhet të caktohet një formë tjetër e emërimit pasi që forma aktuale mbështetet vetëm në komisionin e emëruar nga Kuvendi i Kosovës dhe si e tillë i rritë mundësitë e subjektivitetit dhe ndikimit politik.
- Emërimi i Bordit të KPM-së: duhet të rivlerësohet për t'i ulur rreziqet e subjektivitetit dhe ndikimit politik dhe duhet të vendosen rregulla më të ashpra për lidhjet politike të anëtarëve të bordit.
- Të rriten kompetencat e organeve vetërregullative. Një aspekt i rëndësishëm që është relevant për ta rritur transparencën dhe për të siguruar llogaridhënie më të madhe të mediave është sigurimi i metodave për të kërkuar të dhëna nga mediat, siç është pronësia e mediave. Një aspekt tjetër është përfshirja e mediave online në fushëveprimin e tyre.
- Të sigurohet pavarësi më e madhe editoriale nga të gjitha format e presionit. Mediat duhet të kenë procedura dhe rregullore të mirëfillta si dhe komisione disiplinore të integruara brenda institucioneve të tyre për ta zvogëluar ndërhyrjen e pronarëve, menaxherëve të mediave dhe organeve politike dhe zingjiri hierarkik nuk duhet të jetë imun ndaj këtyre procedurave. Këto politika duhet të përcaktojnë qartë kufijtë editoriale dhe çfarë përbën ndërhyrje. Të rritet pajtueshmëria me standardet profesionale përmes miratimit të Kodit të Sjelljes. Mediat duhet të inkurajohen ta zhvillojnë kodin e tyre të sjelljes ose ta miratojnë atë të organeve vetërregullative dhe të sigurojnë që janë vendosur mekanizmat e duhur brenda secilës media për të siguruar respektimin e tij. Duhet të mbështetet më shuma praktika e ndëshkimeve për anshmërinë në raportim dhe përhapjen e dezinformative. AGK së bashku me FEJ, UN Women, IKD, OSBE, KE dhe akterë të tjerë ndërkombëtarë dhe kombëtarë po zbatojnë trajnime për gazetarët mbi qasjet e duhura për raportimin e lajmeve.

- Duhet të krijohen mekanizma të duhur në mënyrë që të përkrahet zbatimi i legjislacionit. Duhet të rikohet procesi se si trajtohet një kërkesë për qasje në dokumente publike dhe të zhvillohen udhëzime të qarta që do të ndihmonin procesin dhe zbatimin e legjislacionit.
- Të përforcohet pozita ekonomike e gazetarëve dhe roli i Sindikatave. Rregullimi i procedurave të punësimit për gazetarët duhet të zhvillohet dhe zbatohet përmes Inspektoratit të Punës i cili do të kërkojë përmirësim të efikasitetit të tyre në trajtimin e shkeljeve të të drejtave të punës për gazetarët. Tutje, roli i Sindikatave duhet të forcohet dhe duhet të inkurajohen mjediset që mundësojnë zhvillimin e tyre brenda sektorit të mediave private për të siguruar kushte më të mira pune për gazetarët.
- AGK është duke i mbështetur gazetarët në kërkesat e tyre për kushte të përmirësuara të punës përmes avokimit, përfaqësimit në grupe punuese të parlamentit ku diskutohet legjislacioni për mediat dhe do të vazhdojë t'i mbrojtë të drejtat e gazetarëve kur ato nuk respektohen.

